

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 162, Prill 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", duhet të eci, duhet të jetojë!

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u krijua para pesëmbëdhjete viteve nga një grup intelektualësh me origjinë nga dukagjini si një domosdoshmëri e kohës, çka besojmë se e ka justifikuar veten në përpjekjet për të realizuar misionin e saj, i cili ishte dhe është: "Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat e sakrificat e tëparëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërrë vendin që meriton në Botën e qytetarëve të moderne." Në funksion të këtij misioni shoqata ka përgatitur dhe realizuar shume veprimtari, në të cilin kryesoret kane janë: ...

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

## PËR SHKOLLIMIN, EDHE NË DUKAGJIN U TREGUA KUJDES SHUMË I MADH PAS ÇLIRIMIT TË VENDIT

Përpara se të shprehi disa kujtime dhe mbresa nga jeta dhe punan në arsim dhe kulturë në zonën e Dukagjinit, në kuadrin e 100 vjetorit të shkollës së parë në Dukagjin, uroj nismëtarët e këtij studimi dhe drejtuesit e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" me kryetar zotin Ndue Sanaj dhe redaksinë e gazetës me kryeredaktor zotin Luigj Shyti. Njëkohësisht uroj edhe sponsorizuesit e gazetës "Dukagjini", në veçanti zotin Gjergj Leqeja dhe zotin Ftoni i cili banon në SHBA.

## PUSHUESH NË PAQE, EJA LA MOTËR MBAROI KËTU

Jeta është e pamëshirshme. Kështu është ndërtuar ajo. Në largimin nga jeta nuk ka radhë.

Të vjen keq kur largohet çdo i njohur nga jeta, por më e madhe është keqardhja kur largohen moshë të reja, njerëz të mirë, njerëz të afërt dhe të njohur, kur largohen ata që, siç thotë populli të këputin shpirtin. Një nga këto largime ishte edhe me 3 prill 2017, me vdekjen e parakohëshme të Elisa Uka, një vajzë në moshën 26 vjeçare, nga një sëmundje e rëndë, e cila po kurohej në spitalin e Padovas në Itali. Elisa ishte e bija e Leonorës dhe Mirashit...



## Për shumë mot Pashka!

Në vazhdimësinë e aktiviteteve që Arqipeshvia Metropolitane Shkodër – Pult ka organizuar me rastin e festës së Ringjalljes së Zotit tonë Jezu Krishtit- Pashkëve. Shoqata Atdhetare Dukagjini e përfaqësuar nga disa anëtarë të saj, morën pjesë në këtë festë. Gjatë kësaj vizite u shtërgun duart dhe u shkëmbyen urimet tradicionale. Bariu i Mire, Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra me këtë rast e përgëzoj shoqatën për punën e mirë që po bënë dhe përgëzoj krejt Trevën e Dukagjinit për urdhrin "Nderi i Kombit", që presidenti i Republikës Shkëlqesia e tij Z. Bujar Nishani i ka dekoruar atë. Ky urdhër, tha ai, na nderon të gjithëve dhe sjell për brezat që vini mirënjohjen për paraardhësit e tyre.



## Presidenti Nishani në Simpoziumin "Historia e Mirditës në mes të katedraleve dhe kapedanëve": Ne nuk mund të harrojmë, jo për t'u hakmarrë!

Me datën 29 mars 2017, ditë e mërkurë, në orën 11. 30 deri në orën 13. 00, në qytetin e Rrëshenit, në Pallatin e Kultures, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani u zhvillua simpoziumi, me teme "Historia e Mirditës në mes të katedraleve dhe kapedanëve".

# Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, duhet të eci, duhet të jetojë!



Shoqata Atdhetare “Dukagjini” u krijua para pesëmbëdhjetë viteve nga një grup intelektualësh me origjinë nga dukagjini si një domosdoshmëri e kohës, çka besojmë se e ka justifikuar veten në përpjekjet për të realizuar misionin e saj, i cili ishte dhe është: “Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat e sakrificat e tëparëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërë vendin që meriton në Botën e qytetëruar e moderne.”

Në funksion të këtij misioni shoqata ka përgatitur dhe realizuar shume veprimtari, në të cilat më kryesoret kane janë:

1- Janë përgatite dhe zhvilluar gjashtë simpoziume dhe një seminar shkencore, me temë “Dukagjini në rrjedhat e historisë”: Kushtuar 85 vjetorit të Besës së Prekalit, me temë “Kuvendet Malësore dhe koha”;

Kushtuar 95 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit, 90 vjetorit të Luftës së Planit dhe 90 vjetorit të rënies së heroit të Dukagjinit, Mehmet Shpendit, me temë “Traditat patriotike dhe liridashëse të dukagjinase ne vitet 1890-1920”, që me këtë rast, atdhetari Mehmet Shpendi u dekorua me “Medaljen e Artë të Shqiponjës”; Kushtuar 100 vjetorit të lindjes, një figure të madhe të Dukagjinit dhe të Shqipërisë, At’ Jak Marleka (prof. dr. Luigj Marleka), me temë “Një misionar në Shërbim të Kombit”; Kushtuar vlerave materiale dhe shpirtërore të dukagjinase, me temë: “Kultura materiale e shpirtërore”; Kushtuar femrës dukagjinase, me temë: “Femra dukagjinase në kohe”; Kushtuar gjakmarrjes, me temë: “Gjakmarrja retorike apo realitet”, në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe; Seminar është zhvilluar me temë: “Drejtimet e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit”; Konferencë përkujtimore, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim me shoqatën “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, në “Fshatin e Paqes”, në Shkodër

2- Përgatite dhe nxjerre çdo muaj, duke filluar nga muaji Dhjetor 2003, gazetën e shoqatës, me emrin “Dukagjini”, gjithsej 161 numra.

3- Janë promovuar 67 libra të autoreve dukagjinase, që kanë shkruar kryesisht dukagjinasi për Dukagjinin

4- Me grupin artistik të Dukagjinit, janë organizuar dhe mbështet nga Kryesia e Shoqatës realizimi i 10 mbrëmje arkëtuase, në kuadrin e festave të fund vitit, të Krishtlindjes, të vitit të ri dhe të Pashkëve.

5- Me këngëtarët dhe krijuesit më të mirë të Dukagjinit, u përgatite dhe u dha koncerti folklorik “Folk – 2007”, me rastin e Pashkëve në Teatrin “Migjeni”; Një kon-

cert i tille, i titulluar “Folk - 2008”, “Folk-2009” dhe “Folk-2010” të mbështetur nga Kryesia e Shoqatës, janë dhënë në Teatrin “Migjeni”.

6- Janë hapur:

a) Ekspozita fotografie e titulluar “Kontrast” e fotografeve amator Luigj Shyti dhe Luigj Mila; Ekspozita e punës së 18 piktove dukagjinase, me në krye Artistin Zef Shoshi dhe Mjeshterin Ndoc Gurashi, me temë “Peneli dukagjinase”.

7- Janë përgatitur dhe zhvilluar 14 ceremoni përkujtimore, kushtuar figurave dhe personaliteteve dukagjinase.

8- Janë botuar 2 libra të Shoqatës, me titull “Dukagjini në rrjedhat e historisë”, 1 dhe 2. I pari përmban materialet e simpoziumit shkencor “Kuvendet malësore dhe koha” dhe “Traditat patriotike dhe liridashëse të dukagjinase në vitet 1890 – 1920”, ndërsa e dyti përmban materialet e simpoziumit shkencor “Një misionar në shërbim të kombit”. Është bërë libri i trete, i katërt dhe i pesti gati për botim, por janë në pritje të mundësorëve.

9- Në bashkëpunim me Qendrën e Gruas “Hapat e Lehte”, janë zhvilluar dy veprimtari, me temë “E bukur por e ndryshme”, që në thelb ishte puna që behet për integrimin e banoreve të ri, që kane ardhur nga malësitë në mjedisin qytetar në Shkodër, në lagjen “Mark Lula”.

10- Bashkëpunim me Shoqatën e Miqësisë Kosove-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, janë zhvilluar veprimtari kulturore e artistike, me temë: “Të gëzojmë së bashku”, duke përdorur sloganin: “Jemi vëllezër, qeshim dhe qajmë së bashku”. Gjithashtu, jemi pjesëmarrës në Manifestimin “Zëri i Vëllazërimit – 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017”, në Pejë-Istog, Deçan, Prizren, Kline, Skenderaj, Tuz, Shkodër dhe në Luginën e Rugovës

11- Me ftese të Ansambllit “Dede Gjon Luli”, në Tuz, morëm pjesë në 10 vjetorin e Lumnimit të Nënë Terezës, me 10 tetor 2013

12- Në bashkëpunim me Fototekën “Marubi”, është hapur ekspozita, me temë “Shan Pici - 1938”, i cili ka qenë fotograf i pasionuar pas natyrës dhe nga 110 fotografi që u ekspozuan, 83 foto ishin nga natyra e Dukagjinit.

13- Me ftese të përgjegjësit të Muzeut etnografik “Shtjefen Ivezaj” në Tuz, kemi marrë pjesë në 12 vjetorin e krijimit të tij, me 1 maj 2014.

14- Me datën 17 maj 2014, promovuam dokumentarin “Misteri i një Kreshti”, të autorit Mhill Vata.

15- Me datën 13 dhjetor 2014, u zhvillua ceremonia e promovimit të librit, me titull “Dukagjini, në rrugëtim drejtë gjenezës”, me autor Luigj Shyti.

16- Me datën 15 korrik 2015, përkujtimi i 100 vjetorit i të rënëve në përballje e Madhe të Dukagjinit me ushtrinë Mala-zeze, në Plan

17- Me datën 16 korrik 2015, u bë përuimi i monumentit të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe dhënia e urdhrin “Nderi i Kombit”

18- Me datën 15 tetor 2015, u bë përuimi i monumentit të albanologut Martin

Camaj dhe në bashkëpunim me Senatin Demokristian, u zhvillua një simpozium shkencor, në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së tij, në të cilin ligjëruan nga gjithë hapësirat shqiptare.

19- Morëm pjesë në Manifestimin Letrar “Ora e maleve”, në Rozhaja, me 26 nëntor 2016.

20- Morëm pjesë në Konkursin letrar mbarëkombëtar të poezisë e organizuar nga Klubi Letrar “Podguri”, në Istog, me 3 – 4 dhjetor 2016.

21- Me datën 23 mars 2017, në ora 18.00, në Presidence, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani na u dorëzua urdhri “Nderi i Kombit” për zonën e Dukagjinit. Një arritje e madhe dhe e merituar për kontributet e jashtëzakonshme të Dukagjinit në shekuj në themelet e kësaj Nënëlokeje që e ka emrin Shqipëri.

Po, në këtë datë, një vlerësim i jashtëzakonshëm u bë për dy figura të Dukagjinit, profesor Kole Praelen, me urdhrin “Nderi i Kombit” dhe poetin Frederik Rreshpja, me urdhrin “Mjeshtër i Madh”, pas vdekjes.

Jemi themelues të Klubit Shqiptar të Medias; të Grupit Lokal të Veprimtarisë “Bjeshkët e Namuna” dhe të Grupimit “Aleanca për Jetën”, me qendër në Shkodër.

Gjate kësaj periudhe kemi përgatite gjithë dokumentacionin e lobimin e duhur dhe eshte arrite të dekorohen: Albanologu Martin Camaj, Piktori Lin Delija dhe atdhetari Mehmet Shpendi, me urdhrin “Nderi i Kombit” dhe Kolë Prela. Nga Shoqata “Dukagjini kemi disa figura të nderuara me tituj “Qytetar Nderi i qytetit Shkodër” dhe “Mirënjohja e qytetit Shkodër”.

\*\*\*

I paraqitem këto realizime, jo për t’i bërë analizë punës së Shoqatës në këto pesëmbëdhjetë vite, por për të paraqite para anëtarëve të shoqatës, miqve e mikeve të shoqatës dhe lexuesit të gazetës “Dukagjini” punën që është bërë; me këto arritje, nuk kemi arrite gjithçka. Por, “Ajo që ka rendësi nuk është shumë pushtimi i një pike në hapësirë, ose i një njohje shkencore, sa krijimi i një klime të re morale”, theksonte Giuseppe Bertone. Pra, ne nuk kemi pushuar asnjë lartësi në hapësirë, nuk kemi bërë asnjë njohje të re shkencore, por ne, mendojmë, se kemi krijuar një klimë tjetër morale në bashkësinë tone dukagjinase dhe në bashkësinë ku dukagjinasi kane ngritur çerdhet e tyre familjare. Gjithashtu, mendojmë se kemi arrite të justifikojmë krijimin e kësaj shoqate, të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në shërbim të Dukagjinit, në shërbim të dukagjinase, dhe në të njëjtën kohë në shërbim të shkodranëve e në tërësi të shqiptarisë. Këto arritje nuk janë bërë vetvetiu. Ato janë arrite në saj të një pune të pakusyer vullnetare, jashtë politikës dhe me kontributin e 370 mundësorëve financiar. Gjithashtu, me këto arritje, mendojmë se Shoqata Atdhetare “Dukagjini” duhet të eci, duhet të jetojë, por MISIONI i saj për të ardhmen duhet të jetë i përputhur me ndryshimet e kohës dhe me drejtimin e integritetit të shoqërisë sonë në demokracinë Evropiane. Duhet, që pa harrua të kaluarën, të shohim përpara e të shndërrojmë

shoqatën tonë e sidomos gazetën e shoqatës, gazetën “Dukagjini” në një tribune të paraqitjes së vlerave gjeografike, historike e ekonomike të zonës shumë të pasur të Dukagjinit.

Kjo duhet të arrihet duke promovua e nxite ma shumë ndjenjën e vullnetarizmit si një nga vlerat e çmuara të punës në shoqatën tonë dhe të pa krahasuara me asnjë shoqate homologe a më gjere e në asnjë mënyrë për tu larguar prej saj.

Këto arritje nuk mund të duken kaq të rëndësishme dhe do të ishin të pakuptimta në qoftë se nuk do ti ballafaqojmë me “veprimtari” të mëparshme, të cilat nuk janë realizuar. Pra duke mos u realizuar asnjë, atëherë këto dalin më të dukshme, dalin më të vlerësueshme, çka na bëjnë ne të fitojmë miq të ri, të fitojmë anëtar të rinj të shoqatës, sepse duan të bëhen pjesë e këtyre arritjeve në të ardhmen e më të suksesshme. Pra, ne, me gjithë punën që është bërë, nuk duhet të themi se kemi arritur gjithçka, madje mund të thuhet se kjo që është arrite deri tani duhet të jetë një bazë e fuqishme e sigurte mbështetëse e rëndësishme për të ecur më përpara. Në qoftë se ne, do të themi se kemi arritur kulmin, atëherë ne do të biem në një injorancë, që është e vështirë të dalim prej saj, do të mohonim ecjen e mëtejshme, çka do të na çojë në një vetëkënaqësi të pavlere. Kështu do të na krijohet një e keqe e madhe, e cila po u la të zërë rrënjë, do të jetë shumë e vështirë për ta larguar, sepse kjo e keqe do të ulet këmbëkryq e do të behet zot i shpirtit tënd, i shpirtit tonë, do të jetë më i fortë nga ç’ jemi ne dhe do të na çojë drejtë ndalimit të ecjes përpara të shoqatës.

Paraprakisht misioni i saj duhet të jetë “Emancipimi shoqërorë, si një domosdoshmëri për të qenë më të denjë në shoqërinë moderne, përpjekjet për të pasur një zhvillim më të mirë ekonomik duke u bazuar në historinë dhe në resurset natyrale që na ka dhuruar Zoti, na ka krijuar Natyra”. Sigurisht nuk përjashtohet puna për të njohur më mirë të kaluarën tonë të lavdishme, por në qoftë se deri tani në punën e saj Shoqata ka pasur përparësi atë periudhe, në të ardhmen në punën e saj përparësi duhet të marri emancipimi i shoqërisë, emancipimi i bashkësisë dukagjinase, si një domosdoshmëri e kohës.

\*\*\*

Anëtare e anëtar të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, miq e mike të Shoqatës, lexues të gazetës “Dukagjini”, në muajin shtator 2017 kemi Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës, në të cilën do të diskutohet e miratohet çdo ndryshim i nevojshme për funksionimin e mëtejshëm të saj, si dhe do të behen zgjedhjet e reja për strukturat drejtuese të saj. Prandaj, me kënaqësi presim opinionin tuaj, mendimin tuaj nëpërmjet të gazetës “Dukagjini”, nëpërmjet faqes së fb të Shoqatës, dhe nëpërmjet adresës elektronike, e-mail:nduesanaj@yahoo.it dhe luigjshyti@yahoo.it.

**Ndue Sanaj,**  
Kryetari i Shoqatës Atdhetare  
“Dukagjini”

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

# PËR SHKOLLIMIN, EDHE NË DUKAGJIN U TREGUA KUJDES SHUMË I MADHE PAS ÇLIRIMIT TË VENDIT

Përpara se të shprehi disa kujtime dhe mbresa nga jeta dhe punan në arsim dhe kulturë në zonën e Dukagjinit, në kuadrin e 100 vjetorit të shkollës së parë në Dukagjin, uroj nismëtarët e këtij studimi dhe drejtuesit e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" me kryetar zotin Ndue Sanaj dhe redaksinë e gazetës me kryeredaktor zotin Luigj Shyti. Njëkohësisht uroj edhe sponsorizuesit e gazetës "Dukagjini", në veçanti zotin Gjergj Leqejza dhe zotin Ndue Ftoni i cili banon në SHBA.

Mendimtari e intelektualit i madh Martin Camaj kur është pyetur se nga ishte është përgjigjur shkurt dhe prerë "Jam nga Dukagjini – Albani".

Pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit e huaj, problemi i arsimimit mori rëndësi të veçantë. Në fshatin Abat, Lotaj, Palaj, Theth, etj shkollat u hapën rreth vitit 1945. Në këto shkolla frekuentonin edhe fëmijët e familjeve të fshatrave të tjerë përrreth.

Në Lekaj shkolla është hapur për herë të parë në vitin 1947. Mësues në Lekaj qenë Cin Lufi, Rrik Lufi, Mark Çefa, Mhill Logu, Dodë Grima, etj.

Për zonën e Shalës shkolla 7 vjeçare është hapur në vitin 1953 në Breglumi. Ndërtesa nuk më kujtohet. Arsimi 8 vjeçarë është masivizuar në vitin 1968 e në vazhdim në të gjithë Dukagjinin.

Në Abat shkolla fillore u hap në vitin 1945. Ndërsa ajo 8 vjeçare (klasa e V peste) u hap për herë të parë në vitin 1968, dhe, mësuesi i parë ka qenë një Eqerem por që ja kam harruar mbiemrin, nga qyteti i Shkodrës. Në vitin 1968 kam qenë drejtor në këtë shkollë dhe kujtoj mësuesit Pjetër Smakaj, Zef Fusha, Myqerem Bushati, Mri Smakaj, Ndue Qerimi, Luigj Shyti, Prekë Simoni, Prenda Quku, si dhe mësues Eqeremin, etj.

Arsimi 8 vjeçar në Abat përfshinte edhe fshatrat Pecaj, Lekaj, Nicaj. Për të lehtësuar frekuentimin e nxënësve u hapën shkolla fillore anekse në Pecaj, Nicaj-Shalë, Qetë e Lekajve sepse në Lekaj ishte që në 1947.

Krahas arsimit ditën pranë shkollave që ishin hapur, vazhdonte mësimi pa shkëputje nga puna pranë shkollës në Abat

Është karakteristike për popullin dukagjin, sepse ka qenë qenë shumë i dhënë pas mësimi që në ditët e para që u hapën shkollat dhe shumë dashamirës për shkollën.

Vetëm në fshatin Lekaj, në vitet e para pas çlirimit të vendit ka marë arsim të mesëm dhe të lartë, të kohës, Mhill Dedë Logu, Prekë Sokoli, Vatë Braka, Fran Marash Stani, Martin Çetina, Gjëlosh Nikë Kakia, Ndue Martin Logu, Prelë Kolë Çuni, Pllumb Lulash Vuksani,

Fran Beka, Mirash Zef Preka, Shkurte Rushetja, (mësuesja e pare dukagjinase) Prekë Lulash Quku, Prenda Lulash Çardaku (Quku), Pjetër Dodë Delia, Age Mark Boka (Kometa), etj që nuk po i kujtoj tash. Në Abat u arsimouan Pjetër Kolë Dreni, (ndër mësuesit e parë), Ndue Qerim Quku, Gjin Lekë Mekshi, Age Gjon Arra, etj.

Nga ky kontigjent e të tjerë, me kalimin e kohës, u inkuadruan në funksione të ndryshme në organet drejtuesi të partisë dhe pushtetit në këto fshatra, por edhe jashtë tyre. Nga Lekaj kanë arritur grada shkencore Vuksan Kola dr. profesor dhe pedagog pranë fakultetit të mjeksisë në Tiranë, Zef Delia dr. profesor në mjekësi, Rrok Martin Logu inxhinier, ambasador për 6 vjet pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan, Fran Marash Stani, fillimisht ka shërbyer si mësues në Pog dhe Kuje të Pultit në vitet 1953-54. Më vonë deri sa doli në pension ka shërbyer në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Edhe Vatë Brraka, fillimisht në vitet 1953-54 ka shërbyer si mësues në shkollën fillore në Nicaj Shosh. Më vonë drejtor shkollë në disa fshatra të rrethit të Lezhës, instruktor pranë Kom. Partisë së Rrethit Lezhë. Prekë Sokoli ka punuar në arsim dhe drejtor në shkollën Breglumi, Sekretar i Kom. Ekz.k.p.të Rrethit të Shkodrës për disa vite, por edhe drejtor shkollë në qytet për disa vite. Pjetër Kakia pasi mbaron shkollën e mesme dhe atë të lartë për pikturë, ka punuar disa vite si pedagog panë univeristetit të Shkodrës. Në vitet e para të demokracisë ai fillon bisnesin në përpunim të lëndës drusore në Shkodër dhe është mjaft i suksesshëm. Ka mbi 100 forca pune. Edhe në fushën e mjeksisë stomatologjike ka ecuri mjaft të mirë. Nikollë Çetina dhe djali I tij Bledari janë kualifikuar si mjek në këtë degë. Kristina Lazër Çetina këtë vit mbaroi studimet e larta në pikturë me cilësi të lartë.

Në kujtesën timë ruaj me fanatizëm vitet e para si mësues. Në vitin 1957 më emrojnë mësues në shkollën e Gjurajve të Pultit në të cilën shërbeva 3 vite. Pashë një popull shumë i mrekullueshëm. Edhe nxënësit ishin shumë dashamirës për arsimin. Kryetar i Keshillit të fshatit ishte Zef Gjëlosh Maçi (Ara), një burrë i nderuar, një prind shembullor. Zefin e karakterizonin cilësitë më të mira.

Krahas mësimdhënies në shkollë, mësuesit ishin të ngarkuar me problemet e kulturës, por veçanërisht kujdes duhej treguar për çrrënjosjen e analfabetizmit deri në moshën 40 vjeç. Në shkollën ku fillova punën kishte 49 nxënës dhe nuk kishte mësues tjetër. Mësimi zhvillohej

me sistem 6 orësh.

Së bashku me këshilltarët sipas lagjeve dhe kurseve, kontrollonim ecurinë e përvetësimit të njohurive. Ishin të ndarë në dy grupe sipas njohurive që kishin marrë, pra grupi I parë dhe I dyti. I dyti kishte njohuri më të mira. Mësohej shkrim, kenndim dhe aritmetikë. Metodat ishin shumë të thjeshta, gjithsesi behej një punë e mirë për kohën dhe mundësitë që ishin. Mësimi bëhej sipas lagjeve, sa më afër shtëpive që të mos kishin vështirësi sepse ai zhvillohej pas dite dhe shkonte deri pasi shkonte një apo dy orë natë. Këto kurse dhanë njohuritë e para të shkrimit, leximit dhe matematikës fillestare. Natyrisht nuk ishte një nivel I lartë, por veprime të thjeshta. Ata që u quajten kalues hiqeshin nga lista e analfabetëve. Shumë nga këta u futën në shkollat e mbrëmjes sipas programit shtetëror dhe morën klasat e fillores por edhe shtatëvjeçaren e ndonjë edhe më lart. Nuk kam nostalgji, por është realitet se për arsimin, si edhe në shumë fusha të tjera u punua mirë. U ndërtuan shumë shkolla, u plotësuan me kuadër dhe me bazë material mësimore. Pra ishin kushtet normale për mësim. Por pas viteve '90 të vjen keq me gjendjen e arsimit në të cilën ka rënë gjithandej por po flasim për Dukagjinin. Janë shfaqur analfabetët, janë shkatërruar shkollat, edhe ato që janë funksionale janë shumë të dëmtuara, mungon baza material, ngrohja, dritat, labororet, frekuentimi është me mungesa të theksuara, niveli profesional i mësuesve i ultë, etj. Këto për moshën tonë janë të pa tolerueshme.

Kam punuar edhe në zonën e Shoshit. Mësuesit kanë qenë nga zonat fushore dhe nga Shala, krahas atyre që ishin të paktë në numër që ishin vendas. Arsimit 7 e 8 vjeçarë u hap në Ndreaj, Palaj, Toplanë, Brashtë. Edhe në fshatra të lagëta nga shkolla qendër më e afërt vjeçare, ishin shkollat fillore me klasa kolektive, si në Mollë të Shoshit, Nicaj-Shosh, Sermë të Toplanës.

Në këtë zonë kanë punuar mësues më përvojë të mirë dhe të përgatitur në shkolla përkatëse sipas lëndëve, si: Kolë Çardaku, Mirash Ndreaj, Zef Fusha, Prelë Shytani, Pashko Biga, etj. Kolë Çardaku ka punuar shumë vite në atë zonë, po kështu edhe Mirash Ndreaj ka punuar Ndreaj-Shosh, Xhan-Pult, Palaj, Lotaj, Abat, Gimaj, Vuksanaj.

Fillimin e punës time si mësues e kam në vitin 1955 në shkollën fillore Abat, Punonim bashkë me mësuesen Shkurte Rushetja, që është e para mësuese nga Dukagjini me punë në Dukagjin, Ajo kishte arsim 7 vjeçar, ishte mjaft e

emancipuar jo vetëm me nxënësit por edhe me prindët. Ajo që kishte rëndësi të veçantë qenë vprimtaritë kulturore në shkollë dhe në fshat. Këndonte me çifteli, merrej me organizatën e grave dhe ndihmonte me sa kishte mundësi në emancipimin e tyre.

Në ato vite shkolla e Abatit kishte në vartësi edhe shkollat e Pecajve dhe te Nicajve. Organizoheshin kurset kundër analfabetizmit sipas lagjeve dhe zgjidheshin njerzit që kishin njohuri për shkrim, këndim dhe veprime aritmetike. Njëri nga drejtuesit e kursit kundër analfabetizmit ishte Kolë Rusheta i cili punonte mjaft mirë dhe ishte shumë i përkushtuar. Puna e drejtuesve të kursit ishte vullnetare. Në Lekaj, në periudhën për të cilën po bëjmë fjalë kishte dy grupe. Në këto grupe kishte 17 gra e vajza që ndiqnin kursin. Kurset zhvilloheshin edhe pranë shkollave të cilat drejtoheshin nga mësuesit. Pranë shkollave Abat dhe Lekaj numrin e kursantëve shkonte 20-25 pjesëmarrës. Në përfundim të kurseve organizohej një farë provimi apo testi për të ditur rezultatin e tyre.

Në vitin 1956 emrohem në shkollë në Brashtë të Shoshit. Unë e shumë të tjerë ishim me bazë fillores dhe bëheshin kurse kualifikimi 1 e 2 mujore gjatë pushimeve për të marrë njohuri për zhvillimin e mësimi. Në Brashtë kisha katër klasa kolektive me gjithsej 17 nxënës. Mësimi zhvillohet në shtëpinë e Mark Dedës. Kujtoj ardhjen e Prelë Grimës që kryente detyrën e inspektorit të arsimit për Dukagjinin. E kujtoj me shumë respekt. Ai u shpreh "Kam ardhë këtu me të dhënë ndihmë, prandaj shprehu sikur jemi koleg në këtë shkollë." Më plotësoj disa kërkesa që ia parashtrova, në bashkëpunim me pushtetin vendor të fshatit Brashtë.

Nga Brashta jam transferuar në Qeresh të Gjurajve ku kam qëndruar tri vjet. Pastaj jam transferuar në Vuksanaj, në Kodër të Stënës, po me klasa kolektive dhe kisha 23 nxënës, siç kam shkruar edhe më lart.

Uroj për punën e mirë që po bën kryesia e shoqatës dhe grupi i punës pranë për të gjithë punën e saj, por në këtë moment në veçanti për punën që po bëjnë për ndriçimin e punës mësimore dhe kulturore në Dukagjin, në këto 100 vjet që nga fillimi i hapjes së shkollave për të mësuar në gjuhën shqipe.

MARTIN ÇETINA

# Për shumë mot Pashka!

Në vazhdimësinë e aktiviteteve që Arqipeshvia Metropolitane Shkodër – Pult ka organizuar me rastin e festës së Ringjalljes së Zotit tonë Jezu Krishtit- Pashkëve. Shoqata Atdhetare Dukagjini e përfaqësuar nga disa anëtarë të saj, morën pjesë në këtë festë. Gjatë kësaj vizite u shtërgun duart dhe u shkëmbyen urimet tradicionale. Bariu i Mire, Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra me këtë rast e përgëzoi shoqatën për punën e mirë që po bëjnë dhe përgëzoi krejt Trevën e Dukagjinit për urdhrin “Nderi i Kombit”, që presidenti i Republikës Shkëlqesia e tij Z. Bujar Nishani i ka dekoruar atë. Ky urdhër, tha ai, na nderon të gjithëve dhe sjell për brezat që vini mirënjohjen për paraardhësit e tyre.

U trokitën gotat dhe u dhuruan vezë – simbol i kësaj feste. Gëzimin që sjell tek të gjithë festa e Pashkëve, ku vdekja ngadhënjëu mbi vdekjen, na fton për të vijuar jetën duke dhuruar Paqe dhe Dashuri.

Tani për të gjithë dy fjalë për kuptimin e kësaj feste.

Pashka është kremtimi më i madh i kalendarit liturgjik të Kishës Katolike dhe të kishave të tjera të krishtera, që kremtojnë Ringjalljen e Jezusit të Nazaretit ndodhur, sipas Besëlidhjes së Re, tre ditë pas vdekjes së tij në kryq.

Java para Pashkëve është quajtur Java e Shenjtë, dhe ajo përmban Tri Ditët e Pashkëve, që përfshijnë Të Enjten e Shenjtë, që përkujton Darkën e Fundit, Të Premten e Shenjtë, që përkujton kryqëzimin dhe vdekjen e Jezusit. Në krishterim-



in perëndimor, Sezoni i Pashkëve, fillon të dielën e Pashkëve dhe zgjat shtatë javë, duke i dhënë fund me ardhjen e ditës pesëdhjetë. Në Ortodoksi, sezoni i Pashkës fillon ditën e Pashkës dhe përfundon me ardhjen e ditës së dyzetë, festën e Ngritjes.

Ka shumë hamendje mbi vitin e vdekjes së Jezusit. Festa e Pashkëve të krishtera është e lëvizshme, vendoset

çdo vit të dielën pasuese, të parën hënë të plotë pasbaraznatës (ekuinoxet) të pranverës (21 marsi). Ky sistem u fiksua përfundimisht në qv. e VI. Në lashtësi mund të kishte përdorime të ndryshme vendore mbi ndjekjen e datës, sidoqoftë të gjitha të lidhura me njehsimin e pashkëve hebraike. Në veçanti disa kisha të Azisë



ndiqnin traditën e festimit të pashkëve në të njëjtën ditë me ato hebraike, pa përfillur të dielën.

Roza Pjetri

## Lamtumirë Zef Lulash Sokoli

Zef Lulash Sokoli, me datën 5 prill 2017, pas një sëmundje të rënde, të pashërueshme, me të cilën u ndesh shumë, beri përpjekje të jashtëzakonshme dhe tregoi një vullnet të hekurt për ta mposhtur atë, por ajo, sëmundja u tregua më e fortë, e cila ja mori jetën dhe e ndau prej nesh fizikisht.

Kjo na ka pikëlluar të gjithëve, sepse rapë kishim nevojë që ta kishim midis nesh, jo vetëm familja që humbi njeriun më të dashur të saj, por edhe të gjithë ne, shokët e miqtë e tij të shumtë. E donim rapë kontributin e ndihmën e tij.

U lindi 74 vjet më parë në një familje të nderuar e fshatit Lotaj me tradita atdhetare. Ishe pasardhës i denjë i Lulash Sokolit e Sokoli Vuksanit, që me punën e përkushtimin e tij, ja rriti ende më shumë emrin e mirë, që kjo familje ka pasur ndër breza.

Tek Zefi ishin gërshtuar më së miri vetit e virtytet më të mira që trashëgoi nga të parët e tij, të cilat u duken në formimin e gjithanshëm që tregoi në jetë, në secilin punë që e ngarkuan dhe mori përsipër. Kudo, ku punoi, në detyra të ndryshme

shoqërore, ekonomike apo private është shquar për korrektesë, ndershmëri e përkushtim. Kishte një mënyrë të veçantë



komunikim me njerëzit, e cila e bëri që mos të kishte armiqësi me askënd, por ti shtoheshin miqtë e dashamirët për dite.

Zef ishte një prind shembullor, që së bashke me bashkëshorten, Zojen, patën, rriten e edukuan gjashtë fëmijë të mrekullueshëm, Vuksanin, Tazen, Gjyshten, Sosen, Fatmirën e Shpresën, të cilët rrezatojnë kudo vetëm mirësi, plotësisht pasqyren e prindërve të tyre.

Zef ishte unikal, jo vetëm në Dukagjin, por edhe më gjere, në veçanti për kontributin e madh në ruajtjen dhe pasurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore - etnografike, që si një artizan duarartë, zbukuroi koncertet dhe veprimtaritë e shumta e të ndryshme me veshjet tradicionale, që dilnin nga duart e tij punëmëdhaja, siç ndodhi edhe në Presidencë, në të cilën u zhvillua ceremonia e dekorimit të zonës së Dukagjinit, me urdhrin “Nderi i Kombit”.

Ai gjithmonë ka qenë i etur për dije, ka qenë një studiues e hulumtues i kujdeshëm. Punën e tij studimore e pasqyroi në gazetën “Dukagjini”. E veçante ishte puna e tij e madhe, në hulumtimin e studimin, së bashku me bashkëautorin, zotin Lulash Ndos Gilaj, për fshatin e lindjes,

që e permbloren në librin, të pagëzuar me emrin “Lotaj e Shalës”, të cilën jua la dhurate bashkëvendlindasve të tij, si domos brezave, duke mbet i pavdekshëm në memoriejen e tyre.

Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” i shprehim familjes së Zefit ngushllimet tona më të sinqerta për humbjen e njeriut të tyre të zemrës dhe shprehim besimin se ketë dhimbje do të dine ta përballojnë, siç e ka dhenë edhe Zefi shembullin në jetën e tij. Zefi po ju lenë fjalën e mirë dhe shokë dhe miq të shumtë, të cilët do t’ ju qendrojnë pranë në çdo kohë.

Ju shprehim ngushllime edhe në emër të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë – Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, në të cilën Zefi ka fituar respektin e tyre si pjesëmarrës në të gjitha veprimtaritë që kemi zhvilluar me ta në Shkodër, në Kosovë e në Mal të Zi.

Jo vetëm familja humbi njeriun e tyre të dashur, por edhe ne, Shoqata humbëm veprimtarin më të devotshëm, Anëtarin e Nderit, të cilin do ta kemi burim frymëzimi.

Lamtumirë i dashur Zef!

Pushofsh në paqe e Zoti kjoftë mirë me ty në jetën e amshueme!

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Prele Shytani

# Presidenti Nishani në Simpoziumin "Historia e Mirditës në mes të katedraleve dhe kapedanëve": Ne nuk mund të harrojmë, jo për t'u hakmarrë!

Me datën 29 mars 2017, ditë e mërkurë, në orën 11. 30 deri në orën 13. 00, në qytetin e Rrëshenit, në Pallatin e Kultures, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani u zhvillua simpoziumi, me teme "Historia e Mirditës në mes të katedraleve dhe kapedanëve".

\*\*\*

Për këtë, Presidenti i Republikës, bëri një vizitë pune në Mirditë.

Në këtë rast, fillimisht u ndal në Kishën e Shën Llezhdrit në Orosh (Ish-Abacinë) duke u mikpritur nga Imzot Cristoforo Palmieri, Ipeshkv i Dioqezës së Rrëshenit dhe besimtarë të shumtë. Presidenti Nishani vizitoi edhe Shkolën e Mesme Profesionale "Shën Jozef Punëtori" ku u takua përzemërsisht me nxënësit e mësuesit duke theksuar rëndësinë e shkollimit të përfuturit të dijeve, ruajtjes e pasurimit të vlerave dhe traditave më të mira të Mirditës, si dhe mori pjesë në ceremoninë e dhurimit të disa fidanëve pemësh frutore mani nga bamirësja austriake Marianne Graf.

Më pas Kreu i Shtetit shqiptar për-



shëndeti Simpoziunin "Mirdita në mes të Katedraleve dhe Kapedanëve" në Pallatin e Kulturës të Rrëshenit, të organizuar nën kujdesin e Institucionit të Presidentit të Republikës ku ishin të pranishëm gjithashtu deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, kryebashkiaku i Mirditës Ndrec Dedaj, kryetari i Bashkisë Lezhë, Nënprefekti i Mirditës, autoritete dhe përfaqësues të pushtetit vendor, Imzot Palmieri dhe klerikë, historianë, akademikë, profesorë dhe banorë të shumtë të Mirditës e familje të shquara të saj. Ne kete veprimtari mori pjesë dhe nje grup i Shoqates At-dhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Roza Pjetri dhe Mirela Gjoni.

Në fjalën e Tij me të këtë rast, Kreu i Shtetit, pasi u shprehu falënderimet për mikpritjen dhe vlerësoi referuesit e ndryshëm për punën e tyre intelektuale, kërkimore-shkencore sepse "kështu do të mbahet gjallë trashëgimia e jashtëzakonshme e vlerave historike dhe identitare

shumëshekullore", theksoi mes të tjerash: "Gjatë këtij muaji kam pasur rastin të udhëtoj në shumë treva shqiptare. Isha para disa javësh në Preshevë e Bujanoc, më pas në Gjirokastër, sot në Mirditë dhe kudo ku shkon gjen shpirtin dhe identitetin kombëtar shqiptar, zakonet, kulturën, dallimet e kësaj trashëgimie."

Presidenti i Republikës vlerësoi me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" Preng Marka Prengën (pas vdekjes) dhe Frrok Melyshin (pas vdekjes); ndërsa me Dekoratën "Nderi i Kombit" Preng Bibë Dodën (pas vdekjes) si dhe me Dekoratën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" Derën e Gjonmarkajve me motivacionin: "Për kontributin e jashtëzakonshëm në shërbim të mbrojtjes së identitetit kombëtar dhe në mënyrë të veçantë, të trevës së Mirditës, për luftën shumëshekullore kundër pushtuesve të atdheut dhe për rezistencën e tyre deri në sakrificë sublime, kundër vendosjes së diktaturës komuniste në trojet shqiptare".

Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"

## PANAIRI I TIRANËS I QUAJTURI "FANOMI I SHËN LLESHIT"

Ndoc Selimi

Kohë më parë, mbase edhe 40 vjet të kaluara, dëgjova një mikun tim tiranas, që i thotë një tjetri "Hik more plak Shën Lleshi". Në kuriozitet për këtë thënie e pyeta, se ç'do të thotë kjo shprehje?!. As ai nuk e dinte, por më tha, kështu e kam dëgjuar.

Më vonë gjate studimeve e leximeve të ndryshme e ndesha këtë thënie, e cila kishte një histori të tërë mbrapa.

Shekuj me radhe, në Tiranë zhvillohej një panair pranveror çdo dite të enjte, të javës, ku fshatarët e të tjerë sillnin prodhimet e tyre e kryesisht gjera blegtorale si djathë, kafshe të gjalla, edha (keca), dhi, dele, produkte qumështi, lesh e të tjera, por edhe zejtarët sillnin zejet e tyre.

Kjo beheje më e madhe në fund të muajit maj, para se blegtorja të dilte për verim në bjeshkë. Në shekullin e XVIII panairi i quajtur "Fanomi i Shën Lleshit" kaloi në vartësinë e Teqesë së Kubatit, në Tiranë, për të cilën Sulltani kishte lëshuar një ferman, që të ardhurat e taksave të kalonin për të vobektit dhe kryesisht për ushqime, gjë të cilën, Teqeja e bënte në mënyrë më rigorozë. Ky panair mbyllej dy dite para se të hynte muaji qershor, pasi i lihej radha një tjetër panairi të madh, në Elbasan i quajtur Panairi i Shën Valentinit, që ishte pranë manastirit dhe varrit San Valentinit, në afërsi të këtij qyteti.

Në fillimet e saj, që mund të jenë edhe më shpejt se shekulli i XV, panairi zhvillohej në fushën e Shallvareve deri kur kjo fushe u be për sportet. Pas Luftës së Dytë Botërore, s'pостоhet në afërsi të Brrakës, në veri - perëndim të saj. Deri në vitet 50' vazhdoi duke u s' postuar dhe e fundit ishte te rruga antibiotikut, ku ndahet rruga për Kinostudio. Pas viteve 50' u pa si i rrezikshëm dhe u mbyll përgjithmonë.

Gjate ditëve të panairit ishte një gjë e jashtëzakonshme. Aty jepeshin shfaqje, estrada, sazexhinj, vallëzohej nga çinxhijet, vinin rome me arinj të zbutur, që kërcenin nën ritmet e dajres, por edhe kloun që zbatimnin publikun. Këta karagozë visheshin si pleq të mjere, me rreca duke sjelle një paraqitje të shëmtuar dhe së fundi kjo paraqitje u dha rast banorëve të Tiranës të përdornin fjalën gati për

ofendim "plak Shën Lleshi" duke dale te ajo që kisha dëgjuar nga Cufi i Farkës, në fillim.

Shume njerëz janë të mendimit se ky panair u krijua në vitin 1781, kur sulltani Abdyl Hamiti i lëshon fermanin, që të ardhurat e këtij panairi të kalonin për të vobektit dhe për këtë autorizon Shehun e zavijës, Rexhep Khalife, për ndjekjen



e këtij rregulli. Kujtojmë, se ky ishte fermani i dyte, pasi i pari kishte humbur.

Edhe si datë e krijimit të panairit u quaj pikërisht data e fermanit e lëshuar me 1781, Panairi i Shën Lleshit kishte shekuj më parë që funksiononte. Shprehja, që Panairin e Shën Lleshit të Tiranës e ka krijuar Teqeja e Kubatit nuk mund të jetë e besueshme. Këtë pohim e bën të mundur emri i panairit "Shën Lleshi", i cili është një shenjtor i krishtere e kryesisht katolik dhe nuk mund të krijohej nga një Teqe Islamike. Emri Shën Llesh, pra shenjtit të gjithë shqiptareve (Aleksandërit), me të cilin janë lidhe fatet dhe historia e vendit

(Aleksandëri i Mollosve, Aleksandëri i quajtur Skënderbe, Kisha e Shën Aleksandërit në Malin e Shenjtit, kishat me shumice në Shqipëri, me emërin e Sh' Llezhdrit e të tjera, konfirmojnë ma së miri origjinën para turke). Po, një tjetër panair me emrin e Shën Aleksandërit zhvillohej në Krujë. Sipas L. Tacchela (Giorgio Castriota Skanderbeg e i Romani Pontefici nel sec. XV, Milano, 2000, fq. 59 - 65. ) thuhet, se një manastir kushtuar Shën Aleksandërit përmendet që në shekullin e XIV, në dioqezën kishtarë të Arbërisë, e cila mbulonte kishtarisht si trevën e Krujës, ashtu edhe të Tiranës. Ky manastir përmendet me 1319, me emrin "Manastiri i Shën Aleksandërit të dioqezës së Arbërisë" (Sanctus Alexander monasterium diocesis Albanensis ) dhe me 1399, me emrin e thjeshtë "Shën Aleksandri i Madh i Arbërisë" (S. Alexander major de Albania).

Kështu mund të përfundojmë, se ky panair ishte shekuj më parë dhe se Teqeja e Kubatit vetëm sa ka vjelë të ardhurat dhe jua ka shpërndarë për ushqime të vobektëve.

Në vitet 50' u pa i panevojshëm, që ky panair me një urdhër të veçantë të shtetit komunist u ndalua përgjithmonë.

(Fermani i sulltanit është përkthyer nga Ferid Vokopola. Shumë të dhëna janë marre nga K. Frasherri, Hahn dhe I. Zamputi)

# PUSHOFSHINË PAQE, FJALA MOTËR MBAROË KËTU

Jeta është e pamëshirshme. Kështu është ndërtuar ajo. Në largimin nga jeta nuk ka radhë.

Të vjen keq kur largohet çdo i njohur nga jeta, por më e madhe është keqardhja kur largohen moshë të reja, njerëz të mirë, njerëz të afërt dhe të njohur, kur largohen ata që, siç thotë populli të këputin shpirtin. Një nga këto largime ishte edhe me 3 prill 2017, me vdekjen e parakohëshme të Elisa Uka, një vajzë në moshën 26 vjeçare, nga një sëmundje e rëndë, e cila po kurohej në spitalin e Padovas në Itali. Elisa ishte e bija e Leonorës dhe Mirashit.

Ajo u lind në Shkodër më, 16.8.1990. Bashkë me vëllain Ervisin kaluan një fëmijëri të lumtur dhe plotë kulturë pranë prindërve të tyre që aq shumë u kujdesën për mirërritjen e tyre.

Elisa mbaroi ciklin e ultë të shkollës 9 vjeçare pranë shkollës "Pashko Vasa" dhe ciklin e lartë në shkollën "Vasil Shanto" në mënyrë të shkëlqyer. Shkollën e mesme e mbaroi në shkollën "At Pjetër Mëshkalla" me notën mesatare 9.5.

Ishte shumë e dashuruar pas dijes dhe kulturës, veçanërisht pas letërsisë. Dëshironte të studioje për gjuhë letërsi, por, disi e ndikuar, dhe me insistimin e babait të saj, pasi kishte profesionin e ekonomistit, edhe Elisa studioj për financë kontabilitet pranë fakultetit ekonomik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" të cilin e mbaroj me 15.7.2013.

Elisa dëgjoj porosinë e babës dhe

studioj aty ku mund të kishte më mundësi për të ardhmen e saj.

Më pas vazhdoj masterin profesional, por ja ndërpru sëmundja e nuk arriti që ta përfundojë. të gjitha kushtet për këtë qëllim.



Elisa filloj punë në Drejtorinë Rajonale Sigurimeve Shoqërore në Shkodër, por pas 3 muajve, sëmundja e pamëshirshme, e rikthyer, nuk e lejon të vazhdonte më tej.

Mirashi, Leonora dhe Ervisi ishin shumë të interesuar për shkollimin e Elisës, prandaj dhe i krijuan të gjitha kushtet për këtë qëllim.

Elisa, megjithëse në moshë të re, ishte shumë aktive në punë, në marrëdhëniet shoqërore. Ishte shumë e dashur me familjarët, të afërmit, me shoqërinë, ishte e qeshur dhe e ëmbël në festat familjare dhe verimtaritë shoqërore.

Me datën 23.1.2017 Elisa merr biletën vajtje ardhje për tu kthyer me 27.1.2017 për të bërë një vizitë shëndetësore pranë spitalit onkologjik të sptalit universitar të Padovas në Itali, por ashtu siç është shprehur baba i saj, Mirashi, ajo shkoj me avion të bardhë dhe u kthye në akrihol të bardhë.

Elisa e donte jetën. Edhe pse e sëmurë nga një sëmundje e rëndë, ishte optimiste, e pathyeshme, nuk jepej, kishte shpresë, besonte në shërimin e saj, aq sa u fliste njerëzve të afërm kur i shikonte të shqetësuar të cilët qëndronin pranë saj. Por nuk arriti të mbijetonte.

Vëllai i Elisës, Ervisi, vetëm pak minuta, pasi e rrëmbu vdekja për në amshim, shkroi për motrën e vetme të tij në rrjetin social: "Pushofsh në paqe. Fjala motër mbaroi këtu". Këto fjalë të dalura nga zemra janë të thella dhe të përmadhshme pa fund, por duket se nuk ka fuqi shpirtërore që të shkruaj gjatë, mbase edhe mërzia dhe loti nuk e lejojnë.

Vdekjen e Elisës e bën edhe më dhimbshme fakti që ishte e fejuar, e që tashmë nuk prekte vetëm familjen dhe të afërmit e saj por edhe të fejuarin Nand Samarxhiu dhe familjen e të afërmit e tij. Ai është punonjës pranë shërbimit të provës të Ministrisë së Drejtësisë, dega

Shkodër. Nandi, bashkë me Leonorën, nënën e Elisës dhe vëllain e saj, Ervisin, si dhe me shumë të afërm të tjerë i qëndruan pranë Elisës deri sa mbydy sytë përgjithmonë. Sytë e tij nuk nuk u thanë asnjëherë. Ne kemi shkëputur nga rrjetet sociale një përkushtim të tijë, por, që e kemi të vështirë edhe që ta rishkruajmë: "Zoti të dhashtë lumninë e parrisit! Ti ishe kuptimi i jetës tëme. Por, zoti të deshi afër tij. Unë tash e në vazhdim kam një ëngjëll atje lart në qiell që do kujdeset për mua, gjatë gjithë jetës time, dhe ky ëngjëll je ti. Lamtumirë zemra ime."

Baba i Elisës është ndër themeluesit e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", e gazetës "Dukagjini" që është e vetmja gazetë që del në Shkodër rregullisht prej 14 vitesh, dhe financier i shoqatës për disa vite, gjë të cilën e shikonte me respekt edhe Elisa.

Elisa u përcoll për në banesën e fundit midis dhimbjes, përmadhimeve, lotëve dhe vajit, jo vetëm të nënës Leonora, vëllait Ervisi, të fejuarit Nandi, por edhe shumë e shumë njerëz u përletën dhe nderuan me heshtje deri në zbritjen për në banesën e përjetshme të saj. Njerëz të panumërt e përcollën, u përcollën para arkivolit me trupin e saj, ngushëlluan me shumë respekt prindërit, të fejuarin e saj, familjarët, dhe të afërmit e saj. Për vlerat e saj dhe familjes së saj morën pjesë në përcjedhjen e saj edhe zoti Ditmir Bushati, zoti Namik Kopliku, zonja Jozefina Topalli, zoti Zef Çuni e shumë personalitete të tjera vendore. Qindra ngushëllime ka marrë familja, në gjitha rrugët e komunikimit, për ndarjen e Elisës nga jeta.

Kryetari i shoqatës "Atdhetare Dukagjini", Ndue Sanaj me rastin e vdekjes së parakohshme të zonjushës Elisa Uka, në rrjetin social fb, i shkruante babës së saj: "Mik, festa e Pashkës ju dhashtë forca për përballimin e vdekjes së parakohshme të vajzës tuaj të dashur. Zoti ju ruajt".

Korepondenti i gazetës  
"Dukagjini"

## KONFERENCA SHKENCORE NDERKOMBËTARE "ZOJA E SHKODRËS, DRITA E SHQIPNISË"

Me 22.4.2017, në mjediset e Seminarit Ndërdioçezan "Zoja e Këshillit të Mirë" në Shkodër zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, me rastin e 550 vjetorit të shpërnguljes së figurës së Zojës së Këshillit të Mirë (Zoja e Shkodrës) nga Kisha bri Kalasë së Shkodrës për në Genazzano, Itali.

Konferencën, në emër të këshillit organizativ të konferencës e hapì Dom Artur Jaku, rektor i i Shenjëtores "Zoja e Këshillit të Mirë". Pastaj të pranishmit i përshendeti Monsinjor Anxhelo Masafra, Kryetar i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.

Konferenca i zhvilloi punimet në dy seanca. Seancën e parë e drejtuan Luçia Nadin, Evalda Paci dhe Nikë Ukgjini, ndërsa seancën e dytë e drejtuan Itali Sarro, Nevila Nika dhe Edmond Malaj.

Folën 14 autor nga Shqipëria dhe jashtë saj. Në ato kumtesa u fol për figurën e Zojës së Këshillit të Mirë,

dashuria dhe shpresa e popullit shqiptar gjatë përshtirjeve dhe gjithnjë, teknikat e punimit të pikturës, të dhëna të interesante rreth shpërnguljes së figurës së Zojës së Këshillit të Mirë për në Genazzano në Itali, përballja e popullit shqiptar me rrebeshet e kohës, motive përshtirjes në shqipëri kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë, studime bërthamore mbi pigmentet e përdorura në punimin e pikturës, teknika e realizimit të pikturës murale, të dhëna nga arkivi i Vatikanit, etj.

Gjatë paraqitjes së kumtesave u shfaqën edhe mendime në lidhje me punimet, në shërbim të një kuptimi më të mirë në lidhje me idenë e folësve.

Korespondenti i gazetës  
"Dukagjini"



# KUZHINA NGA DUARTË E GJYSTE (ÇARKU) BICI NË NJË LIBËR


Si edhe në shumë drejtime të tjera, Malësia e Shkodrës është shumë interesante dhe e pasur edhe në përgatitjen dhe përdorimin e llojeve të ndryshme të ushqimeve, që tradicionalisht kanë ardhur duke u ndryshuar dhe përmirësuar nga koha, dhe që janë sot të mundshme dhe në përdorim të përhershëm apo të përkohshëm. Përmirësimi dhe përshtatja e llojshmërisë apo cilësisë së ushqimeve janë rezultat i punës së amvisave, (ranga-toreve) dhe fantazisë së tyre. Sot kemi në dorë një librin "Kuzhina unike e Malësive të Shkodrës" e shkruar kujdesshëm dhe plot pasion nga Gjyste (Çarku) Bici, i cili është sa interesant, po aq dhe praktik për përdorim të gjerë në çdo kuzhinë në malësi, por edhe në hapsirat shumë më të gjera.

Ky libër tregon se si mund të përgatiten bukë dhe ushqime të shijshme, të freskëta, të shëndetshme dhe ekonomike. Kjo vjen, siç shkruan zonja Gjyste në librin e saj, që mund të quhet edhe manual përdorimi në kuzhinë, si një punë veçanërisht të grave dhe vajzave në malësi në kërkim të më të mirës, duke u terhequr nga përvoja e njëra tjetrës apo të zonave më në distancë.

Gjyjtja është lindur në Theth dhe është martuar në Vukël, Kelmend. Ajo nuk i ndanë asnjëherë në jetën e saj këto dy vende. Për punë të mirë dhe marrëdhënie të mira shoqërore Gjyste Bici drejton shumë kujdesshëm organizatën e Gruas në Vukël për 22 vjet.

Ajo bashkë me bashkshortin, Ndue Bici

dhe fëmijët udhetojnë dhe qëndrojnë 8 vjet në SHBA, më pas çifti Bici kthehet në Shqipëri. Në Shqipëri i vihet punës duke i bërë thirrje ndërjegjes së vet: "Dua të bëj diçka për vendlindjen dhe malësinë



time". Puna që bënte me mirë dhe më e mundshme ishte kuzhina sepse kishte një përvojë shumë të mirë në vite edhe aty ku ishte lindur dhe atje ku ishte martuar. Marrë pjesë në konkursin e për kuzhinë dhe zënë vendin e dytë në shkallë republikane.

Në librin që kemi në dorë përshkruhen 138 lloje buke dhe ushqimesh që përdoren dhe mund të përdoren në

malësi, por edhe kudo që dëshiron njeriu, mjafton të mësojnë si përgatiten. Dhe mënyra e përgatitjes është e shpjeguar mirë në këtë libër.

Autorja e këtij libri është treguar



dashmirëse edhe ndaj përvojës të të tjerëve. Ajo ka marrë disa ushqime nga zona të tjera të cilat i përgatitë vetë dhe mund të përgatiten nga amvisat në Malësinë e Shkodrës. Ajo është përqëndruar në ato zona që kanë natyrë të përafërt me Alpet Shqiptare dhe mundësinë e bazës materiale.

Është interesant kujdesi i treguar nga shefe Gjyjtja për të bërë të ditur edhe

vjetërsinë e disa ushqimeve që datojnë me shekuj, ndoshta edhe mijëvjeçar, siç është p.sh. mishavina, jarduni, e të tjera.

Tash të gjithë ata që punonin me të e quanin "shefe", për përvojën që ka dhe që e ka demonstruar publikisht e shikojme se ka bërë një rrugë jo të shkurtër sa në një restorant në një tjetër duke dhënë përvojën e saj, si puna në restorantin "Karlsberg" në Tiranë, shefe kuzhinë në restorant "Sanfarnisko" në Shkodër por edhe në "Kulla e Art". Shefe Gjyjtja ka organizuar dhe drejtuar drekën në përfundim të kompanijës së Kishës së Bajzës. Disa vite ka punuar si shefe kuzhine në Theth në shërbim të turistëve të shumë që vinin aty.

Si specialiste, në këtë fushë, ka dhënë mësim në "Dom Boska" në Shkodër dhe në kursin "Kuzhina Shqiptare Tradicionale" dhe ka bashkëpunuar me shoqatën "Vis Albania". Mësimet që jepte zonja Gjyste kishin si qëllim njohjen, përpunimin dhe përhapjen e ushqimeve tradicionale sa më shumë me që kanë shumë vlera. Gjyjtja është një specialiste për tu lavdëruar edhe në fushën e etnografisë, veçanërisht për veshjet popullore. Ajo është si organizatore në emisionin "Histori Shqiptare" në Malësinë e Shkodrës. Interesantë është xhubleta, por edhe veshjet e tjera popullore, të ardhura deri në ditët tona nga thellësia mijëvjeçare, për të cilat Gjyjtja nuk lodhet duke folur dhe shpjeguar deri në imtësi.

"E shkrova, këtë libër, ashtu thjeshtë, thotë Gjyjtja, me dëshirën që të mos humb tradita ushqimore në malët tona, dhe brezi i ri të kënë mundësi njohëse dhe menyrën e përgatitjes të këtyre ushqimeve". Dhe vërtetë ky libër ka vlera për sot dhe për të ardhmen.

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"

## NJË TIP I VEÇANTË

PORTRET

Zakonisht, kafën ne me shokë e me miq të artit e pijmë tek lokali i njohur "Tullat e kuqe". Shpesh vjen edhe ai. Por nuk bie në sy. Rri i heshtur. Vetëm dëgjon. Dhe, me kalimin e minutave, ti harron se është edhe ai aty. Madje, njëri prej nesh, një humorist, i tha një ditë. Qënke edhe ti Zan? Kur paske ardhë?

Ai mund të përkufizohet kështu: -Tip që blen dhe nuk shet.

Dikur befatoshem me te, sepse, bisedat tona, vlerësimet apo vretjtet tona për një ngjarje artistike, apo për një personazh arti të Shkodrës, i shihje pas disa ditësh të botuara prej ti në ndonjë gazetë të Tiranës. Duhet thënë se nuk ka gazetë nga ato të njohurat, por edhe tjera më pak të njohura ku të mos botohet herë pas here një shkrim i gjatë, për një shfaqje të suksesshme që zhvillohet në Shkodër, ose nga artistët shkodranë në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, deri dhe në diasporë, përshkruar me imtësi, me detaje...

Para pesë a gjashtë viteve nuk njihje, as

si gazetar, as si poet, apo autor tekstesh. Njihje vetëm se kishte dhe ka edhe sot një dyqan celularësh në qytet. Dhe nuk është i ri në moshë. Është një meso burrë dhe fëmijët i ka të rritur tashmë, burra, siç themi ne këtu në Shkodër. Shpërtheu papritmas dhe sot njihet edhe si gazetar, edhe poet, por më shumë si autor tekstesh për këngë, të cilat në pjesën më të madhe i janë kushtuar qytetit të tij të lindjes, Shkodrës.

E mbaj mend, para pak vitesh kur erdhi në tryezën tonë, dhe me një zë lutës na dha një poezi që e kishte shkruar, si



tekst për këngë. E lexuam, i bëmë ndonjë vërejtje, apo korigjim. Na falenderoi dhe u largua, për të ardhur të nesërmen

me një tekst tjetër, dhe kështu gati çdo ditë, sillte tekste këngësh, që "t'i jepnim vërejtje". Sot, kompozitor të njohur të Shqipërisë dhe Kosovës thurin këngë me tekstet e Zanit, dhe i këndojnë këto këngë këngëtarë të njohur të vendit: Dhe nuk janë pak...janë mbi njëqind këngë të kompozura mbi vargjet e tij. Dhe këto, vetëm në katër pesë vitet e fundit. E çuditshme, por e vërtetë.

Edhe në diasporë, këngëtarët shqiptarë, deri në Neë York e Michigan të SH.B.A. këndojnë këngë me tekstet e Zanit. Hobi i tij janë artistët e njohur të Shkodrës, dhe jo vetëm këngëtarët, por edhe aktorët e njohur të qytetit të tij, të Shkodrës. Shkruan për figurat e njohura të artit dhe kulturës në Shkodër, me adhurimin e posaçëm me përkushtim. Dhe janë mbi 30 artistë shkodranë për të cilët ka shkruar Zani. Madje, po përgatit një libër të veçantë për njërin prej tyre, për "bilbilin" e këngës popullore shqiptare, Bujar Qamilin.

Ashtu siç ka shkruar për "bilbilin" Bik Ndoja sa ishte gjallë ai, pra dëshira apo hobi i tij është të shkruajë për të "gjallët".

Një ditë na tha, me zë të ulët dhe plot mirësi: -Një ditë, pak vite më parë ju dëgjova tek shprehnit habinë dhe revoltën për Bik Ndojën 92 vjeçar që e kanë lënë në harresë në Shkodër, ndërsa Durrësi ka një rrugë që quhet: Rruga "Bik Ndoja". Që atë ditë kam vendosur të shkruaj për

të gjallët, por që e mbajnë "gjallë" dhe nuk e lënë të vdesë Shkodrën. Dhe më pëlqejnë ata që edhe pse nuk jetojnë në Shkodër, e duan dhe e shprehin vazhdimisht dashurinë për qytetin e tyre, në shkrime, në libra. E keni vërejtë "Bedri Islami, shkrimtari dhe gazetari i shquar jeton diku në Europë, por Shkodrën e ka në zemër dhe nuk e harron kurrë!"

Më kujtohet një herë një prej bisedave në lokal, njëri prej nesh tha: -Po të ju pyes juve se kush ka qenë kryeministër në vitin 1934, asnjëri prej jush nuk e di. Edhe unë nuk e di. Por ama se kush ka qenë Migjeni në vitin 1934 të gjithë e dimë. Do kalojnë disa dekada dhe kur t'i pyesin nipat tanë se kush ishte kryeministër në 2015 në Shqipëri, asnjëri nuk ka për ta ditur. Por ama, kush ka qenë Bik Ndoja në atë vit do ta dinë të gjithë. Sepse, artistët nuk vdesin kurrë, Artisti qëndron mbi politikë, sepse jeton më shumë se ai...


Ishte edhe Zani atë ditë, kur diskutuam këtë fakt. Pas dy ditësh lexuam një artikull të tij në një gazetë. Lexuam atë që kishim biseduar në tryezë, atje, në kafenenë tonë, tek "Tullat e kuqe".

Poeti, autor i shumë teksteve të këngëve, gazetar mbi 50 vjeçar, autor i dhjetra shkrimeve interesante në të gjitha gazetët shqiptare, për të cilin po shkruaj, quhet Ramazan Çeka.

Nga FADIL KRAJA

# Karakteristikat e Malësorëve

- TIPARET, VIRTYTET, VETIT E CILËSITË -



Voc Deda

Malësorët në përgjithësi, të Hotit e të Grudës, të Plavës, Gucisë, Pejës, Prizrenit, Gjakovës, Nikaj - Merturit dhe në veçanti të Kelmendit e Dukagjinit kanë jetuar në shekuj rreth kurorës, bukurisë së Alpeve të Shqipërisë. Ato janë besnikë. Ato janë gjerdani i artë kurorës së Alpeve me vlerat më të mira njerëzore. Janë garancia e sigurisë e kufijve të shqipërisë.

Kanë veruar, e kanë pushuar në flladin e lehtë, nën hijen e lisave, të ahut. Kanë marrë aromën e këndshme të mozaikut të luleve shumëngjyrshë. Kanë sodit e shijuar bukurit fantastike të natyrës; kreshtat e naltat të Alpeve të thepisura; malet, luginat, përrenjt, fushat, kodrat të mbushura me blerim.

Kanë dëgjuar këngët e bilbilit, brilante dhe meloditë e tij të bukura, të shoqëruara nga cicërimat e zogjve që shëtisin degë më degë, në ato pyje madhështore me drunj (bimësi) ahut, pishë, lisi, qarri, frashri, blini, plepi, shkoze, mëdhexet, gështenje e të tjera.

Në ato bjeshkë kreshnike e legjendare kanë marrë ajrin e freskët, oksigjenin. Kanë pirë ujë të kristaltë si qelibar shumë i vlefshëm për shëndetin e njeriut.

Aty kanë shijuar bukuritë fantastike të natyrës, pejsazhet, gjelbërimin, blerimin, diellin e qiellin aq të kaltër.

Bukuritë e katër stinëve që ka viti, pranverës, verës, vjeshtës dhe të dimrit. Të gjitha këto bukuri të frymëzojnë, të shlodhin dhe të japin energji të reja në çdo kohë, për të jetuar, por edhe për të përballuar çdo vështirësi në jetën e përditshme.

Krahas këtyre anëve pozitive, malësorët janë të detyruar të përballojnë me shumë sakrificë edhe vështirësitë e natyrës siç janë: terreni malorë shumë i thyer; në dimër të ftohtit, acarit, ngriçat, akullin, borën, shiun, erërat e forta, murlanin, tufanin, stuhit në përgjithësi, punën e krahut, në çdo proces pune, ngarkesën në shpinë e të tjera.

Malësorët janë të kalitur nga ana fizike, nga vetë natyra janë shumë të zgjuar. Janë si kreshnikë, me trup të madh në përgjithësi. Janë të pashëm, të bukur, el-

egant, si burrat ashtu edhe vajzat e gratë.

Vajzave e grave u shkelqen fytyra si në pasqyrë. Kurse burrat i kanë faqet kuq si gjaku, si ajo vera e mirë në shishe të kristaltë. Janë njerëz me personalitet shumë të fortë.

Malësorët, në përgjithësi, kudo që jetojnë, në veri, karakterizohen nga këto tipare, virtyte, veti e cilësi, që këto janë simbolet:

Personalitetit të njeriut. Janë të kompletuar në përgjithësi me anët pozitive në paraqitje e veprime.

Karakterit të njeriut. Kanë karakter shumë të forte, të qëndrueshëm.

Dinjitetit të njeriut. Janë me moral shumë të lartë. Kudo që shkojnë i zbatojnë normat e mirësjelljes, rrezatojnë për mirë.

Vullneti për punë. Punojnë në çdo proces pune dhe nuk e refuzojnë atë, janë të talentuar.

Edukatës mendore. Janë të mençur, të gjykueshëm, arsyetojnë, nuk flasin para kohe.

Edukata morale. Janë të sjellshëm, të respektueshëm kudo në familje, në shoqëri dhe në punë.

Edukata politike. I përshtaten kohës, dinë të vlerësojnë situatën në çdo sistem.

Edukatës estetike. Në përgjithësi çdo gjë e punojnë bukur dhe pastër, me estetikë.

Edukatës fizike. Janë të kalitur, të shkathët, të shpejtë, të fortë për punë, për ecje e të tjera.

Veshjes bukur. Në përgjithësi kanë qejf të vishen sa më bukur, sidomos në raste gëzimesh, festash, për të treguar veten si njerëz me kulturë, me personalitet.

Vendosshmërisë. Janë të vendosur kur flasin. Kanë një shprehje popullore "Muri lot, e burri s'luan nga fjala", janë shumë korrekt.

Këmbënguljes. Kur e marrin përsipër një punë, se lënë pa e përfunduar, pa e çuar deri në fund.

Burrërisë. Janë shumë të rregullt në komunikim, të presin me zemërgjerësi, të shikojnë sy më sy në shtëpi e kudo të takohesh me ta.

Iniciativës. Kanë kurajo të fillojnë çdo punë edhe po e patën për herë të parë.

Qëndrueshmërisë. Studiojnë çdo punë përpara se ta fillojnë, atëherë vendosin.

Besimi në forcat e veta. Besojnë shumë tek dituritë dhe energjitë e tyre mendore e fizike.

Disiplinës. Zbatojnë me fanatizëm rregullat, normat, ligjet dhe janë korrekt në punë.

Ndershmërisë. Janë shumë të sjellshëm në familje, shoqëri e kudo në përgjithësi.

Drejtësia. E peshojnë dhe gjykojnë mirë çdo punë siç thotë një fjalë e urtë: "mos pre pa u matë, se o të del del shkurt, o të del gjatë"

Sinqeriteti. Janë shumë të sinqertë në përgjithësi kur flasin, po kështu në marrëdhënie dhe në punë me cilindo. Janë zemërgjërë dhe tolerantë

Guximit. Janë guximtarë për të kryer çdo punë, në çdo kohë, sado e vështirë

që është.

Trimërisë. Janë trima të çartur, të zotët në përgjithësi. Kanë dhënë prova në çdo kohë për të ruajtur nderin e familjes dhe interesat e kombit shqiptar.

Thjeshtësisë. Në përgjithësi janë të thjeshtë, nuk janë mendje mëdhenj, komunikojnë me cilindo. Janë oratorë, të shprehur në gojë, burrat, gratë e fëmijët.

Besnikërisë. Janë shumë besnik, nuk të tradhetojnë, në çfardo situatë që krijohet.

Mikpritjes. Të pranojnë në shtëpi si me kenë pjesëtar i familjes, të thonë mirëseerdhe në çdo kohë.

Bujarisë. Su dhimbet asgjë për mikun, të japin për të ngrënë e për të pi sa më mirë. Edhe fëmijët të ftojnë në shtëpi.

Miqësisë. E vlerësojnë shumë miqësinë e vërtetë. Kanë shpirtin të bukur e të pastër

Dashurisë. Janë të dashur për njëri-tjetrin, për shokët, shoqet, miqt e të tjerë.

Zemërmirë. Ndhimojnë cilindo kur ka nevojë, në të gjitha format si kanë mundësi.

Talentit. U vjen dora për çdo punë, janë krijues, fantazojnë, punojnë mirë e bukur.

Logjikës. Flasin ngadale, me rradhë, i thërresin mendjes, logjikës para se të flasin me gojë.

Sakrificës. Janë të kalitur dhe të përgatitur për të kaluar çdo vështirësi, sepse i ka bërë vet jeta në ato male; në ato terrene të thyera, e kushte të vështira atmosferike.

Lirisë. Janë liridashës, s'kanë kursyer asgjë për liri dhe pavarësi, kanë dhënë jetën, veç si me le, në luftë kundër pushtuesve, për liri e demokraci.

Patriotizmit. Kanë dhënë prova në të gjitha kohrat, kur e ka lyp nevoja për çështje kombëtare.

Atdhedashurisë. Për mbrojtjen e Atdheut s'kanë kursyer as jetën kur e ka lypë nevoja. Kudo që shkojnë Atdhenë nuk e harrojnë.

\*\*\*

Malësia e veriut, në të gjitha kohrat kanë rritë në djepin e tyre figura e personalitete të shquara që i kanë shërbyer vendit, Atdheut dhe kombit në fusha të ndryshme siç janë:

Mehmet Shpendi, Bajram Curri, Mic Sokoli, Isa Boletini, Jakup Ferri, Hasan Prishtina, Ali Pash Gucia, Sulejman Vokshi, Idriz Seferi, Dedë Gjon Luli, Gjovalin Shkurti, Çunë Lajçi, Lukë Kaçaja, Ndreku Luca, Tinka Kurti, Pjetër Gjoka, Lin Delia, Luigj Marleka, Martin Camaj dhe shumë e shumë personalitete të tjera në fushën e artit, kulturës, kinematografisë, të sportit e të fushave të tjera.

Malësorët kanë qenë ora e bjeshkëve, e kufijve, trojeve dhe fateve të Shqipërisë. Këta kanë luftuar në shekuj:

Për ruajtjen e trojeve dhe të kufirit të shqiptarëve.

Për ruajtjen e gjuhës shqipe (gjuhës amtare) që kanë trashëguar.

Për ruajtjen e traditave, më të mira që kanë ekzistuar nga e kaluara.

Për ruajtjen e dokeve e zakoneve të

mira, që në kohërat pagane.

Për ruajtjen e simbolit të kombit e flamurit.

\*\*\*

Malësorët janë shumë miqësorë, kënaqesh kur i shikon, kur bisedon e komunikon me ta në shtëpi, në rrugë e kudo.

Malësorët, kudo, në çdo familje, kanë në qender të vemendjes edukimin e brezit të ri me këto synime kryesore:

Të njohin historinë e zonës, të Shqipërisë dhe të kombit.

Të duan atdheun si shqiponja folenë

Të duan simbolet e kombit, gjuhën, flamurin e tij.

Të mësojnë fjalët e urta në veçanti për mençurinë.

Të mësojnë gjëgjëzat për të fituar zgjuarsinë e shkathtësinë e mendjes.

Të duan punën dhe jetën si gjënë më të shtrenjtë

Të duan shkollën e kulturën.

Të duan shkencën në përgjithësi.

Të duan familjen e farefisit, që është gjaku i tyre.

Malësorët nga jugu në veri, për shoqërinë në përgjithësi, kanë qenë, janë dhe do të mbeten:

Yll polar: Këta shndrisin me vlerat e tyre në të gjithë hapësirën.

Xhevahir: Rrezatojnë si meteor që zbret nga qielli.

Diamant: Vitalë, shumë energjikë, nuk përkulen përpara çdo vështirësi.

Shkëmb graniti: Janë të pamposhtur nga dallgët dhe stuhitë e ndryshme të kohës.

Flori: Shkëlqejnë me personalitetin e tyre që nuk ndryshket në shekuj.

Malësorët janë brilantë, shumë të fortë, të gjithanshëm. Janë alpinistë shumë të zotët. S'kanë lënë maje pa pushtuar, pa e shkelë me këmbë, në ato Alpet legjendare.

Malësorët janë thesar i vlerave më të mira njerëzore, kudo që janë në trojet shqiptare.

Sot me plot gojë mund t'i quajmë: "Heronjtë e Bjeshkëve."

Këto janë disa nga simbolet dhe faktorët kryesorë, që i bëjnë malësorët krenar, kudo që shkojnë ose punojnë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, në emigracion.

Këto tipare, virtyte, veti e cilësi që shpjegojmë më lart, pasqyrojnë personalitetin, karakterin e dinjitetin e malësorëve. Është dashur punë e madhe në shekuj, nga brezat që kanë kaluar për t'i kultivuar pranë të ndërgjegjes së njerëzve.

Këto tipare, virtyte, veti e cilësi, që pasqyrojmë më lart, duhet t'i zotërojë çdo njeri, në ndërgjegjen dhe në vepërimtarinë e përditshme. Sot, në kushtet moderne bashkëkohore, njeriu duhet të jetë i kompletuar, që t'i përshtatet kohës, të ecë me të rehat e shkencës.

Prandaj duhet të punojnë, çdo prind, çdo intelektual, që të edukojnë brezin e ri, me këto tipare, virtyte, veti e cilësi.

Voc Deda

# Manifestimi "Zëri i Vëllazërisë 2017"

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në bashkëpunim me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", në vijim të traditës, organizoi Manifestimin tradicional "Zëri i Vëllazërisë – 2017". Ky manifestim u zhvillua me datën 22 prill 2017, në Pejë.

Në ora 15: 00 në vijim të veprimtarive, u zhvillua në teatrin "Istref Begolli" promovimi i librit "Gjurajt", me autor Ndue Sanaj, Arben Gjuraraj dhe Vat Gjoni.

Fjalën e hapjes e mbajti koordinatori i Shoqatës "Martin Dreshaj", Rahman Jashari, i cili i njohu të pranishmit me programin e veprimtarive dhe ftoi studiuesin, poetin dhe kritikun, Anëtarin e Nderit të SHAD, Prend Buzhala.

Në fjalën e tij, zoti Prend Buzhala i beri një analizë librit, duke evidentuar vlerat e librit, theksoi se, libri ka vlera të larta për forcimin e vëllazërisë ndërmjet nesh, në të dyja anët e kufirit. Librat nuk kanë kufij dhe ato tregojnë, ndoshta më mirë se shumëçka, se ne jemi vërtetë vëllazër. Banoret e Dukagjinit, të Pejës, Gjakovës e të tjerë s'kanë kufij. Libri nuk i njeh kufijtë. Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve që përdoren në libër, e bisedave për Gjurarajt janë bërë dhe këtu tek ne dhe janë evidentuar në faqet e librit dhe për këtë i falënderojmë autorët. Më poshtë vuri në dukje vlerat historike dhe etnologjike të librit, të cilat secili lexues mund ta gjeje të

shkruar qarte në faqet e librit. Vuri në dukje se libri është shkruar teknikisht dhe sipas teknikave të hartimit të një monografie, me një gjuhë të thjeshtë por të sakte. Argumentet, dokumentet dhe faktet, të nxjerra nga një dokumentacion serioz, nga bisedat me banorë të fshatit Gjuraraj si dhe shumë banorë të vendeve të ndryshme. Në të gjithë këto bashkëbisedime ndjehet dashuria e madhe për vendin nga ato kanë prejardhjen dhe tani kur librin e kanë në dorë të jeni të sigurt se do të ndjeheni krenar për ato që janë shkruar. Fjalën e tij e mbylli duke falënderuar autorët dhe ftoi pjesëmarrësit të ndërmarin nisma të tilla.

Më pas ju dhe fjala z. Aleks Dushi, i cili kishte ndihmuar në përgatitjen e librit si konsulent. Duke folur për librin "Gjurajt", ai vuri në dukje se, është e vështirë të flasësh për këso librash, sepse aty autorët na sjellin shpirtin e tyre e s' bashku me të një fare krenarie që është e lidhur me vendin, me njerëzit e ngjarjet, që kuptohet se për to janë shumë të rëndësishme. Ndjenja kombëtare është e mbrujtur në këto libra sa ato janë gati ta krahasojnë me dëshirën e ndoshta me vete kuptimin e jetës.

Të shkruarit e këtyre monografive kërkon një formim të caktuar kulturor, aftësi historike dhe gjuhësore dhe sigurisht pak nga ajo që njihet me emrin talent për të shkruar.

Në këtë libra gjendet histori, etnografi, gjeografi, sociologji, kulturë dhe shpirti i banorëve, e të tjera, por në mënyrë të veçantë i kushtojnë rendësi shumë të madhe popullsisë që ka banuar dhe banon në këto zona. Shikon pemë gjenealogjike të ndërtuara me kujdes, megjithëse duhet theksuar se në asnjërin nuk ndiqet askund linja e femrave. Ndryshe ndodh në jug ku ajo ndiqet me të njëjtin kujdes si e meshkujve.

Më poshtë u ndalua në dy problem, të cilat i quajti unikale në ndërtimin e monografive që ndërtohen në këtë formë ku evidentoi;

-Pjesëmarrjen e madhe në plotësimin dhe

hartimin e librit. Kjo gjë është e ndare në dy pjesë: - Banor të fshatit Gjuraraj, në 214 faqe, dhe puna e madhe për të ndjekur ngulmime të fisit Gjuraraj kudo ku ato janë dhe sigurisht një pjesë janë nga fshati Gjuraraj, ndërsa të tjerët thjeshtë kanë mbiemrin Gjuraraj. Udhëtuuan në 19 vende të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë të paraqitura në libër me



rreth 100 faqe.

Duke e konsideruar veten: "si në mes të pjesëmarrësve në promovimit e bere në Shkodër", ai vlerësoi mësuesit, nxënësit, anëtarët e "Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe Martin Dreshaj" dhe qytetar të qytetit Pejë, të cilët kishin mbushur sallën e teatrit "Istref Begolli".

Në fund të veprimtarisë, në emër të autorëve të librit e mori fjalën, zoti Ndue Sanaj. Fillimisht falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë promovim. Më pas ai i njohu pjesë-

marrësit me rrugëtimin e bërë nga autorët për ndërtimin e librit duke falënderuar dhe banoret e Pejës, Deçanit dhe Gjakovës, të cilët kanë mbiemrin Gjuraraj. Ne, shtoi ai: "kur- rë nuk do të harrojmë gatishtërinë dhe mik- pritjen e tyre, e cila përveç se respekt ishte dhe shembulli më i mirë që tregonte se ne jemi të një origjine".

Ne, tani vërtetë jemi në dy anët e një ku- firi të çuditshëm, por pothuajse asgjë tjetër s'ka kufi ndërmjet nesh dhe këtë gjë jemi munduar ta tregojmë nëpërmjet faqeve të këtij libri, tha Ai.

Veprimtaria vijoi me lexime nga autore e anëtarë të shoqatës.

Në fund të kësaj veprimtarie, nga Krye- sia e Shoqatës "Martin Dreshaj" u ndanë vlerësime e tituj për veprimtare të saj. Në mes tyre, ju dha titulli "Mirënjohja e Shoqatës Martin Dreshaj" dhe veprim- tarit tonë të paharruar, Anëtarit të Nderit të Shoqatës Atdhetare Dukagjini", Zef Lulash Sokolli.

Në ore 18<sup>00</sup> u zhvillua një Manifestimi më këngë e valle në Restorantin "Vëllazërit Lu- kaj" më pjesëmarrës nga Shkodra, Malësia e Madhe, Peja, Istogu, Klina, Skenderaj, e të tjerë. Grupi kulturor "Rugova", me vallen e tyre popullore ftuan të gjithë pjesëmarrësit. Gjate kësaj veprimtarie e morën fjalën, për- faqësues zyrtarë dhe anëtar të shoqatave. Në mes tyre foli dhe njeri nga autorët e li- brit, z. Arben Gjuraraj. Ai falënderoi organiza- toret dhe të gjithë ato që dhanë mendimet e tyre për librin. Ne, tha Ai, shkruam për një fshat të vogël, por me një dashuri të madhe, besoj se ja kemi arritur këtij qëllimi, sepse bashkëpunuam me shume gjurjane brenda dhe jashtë asaj, që e quajmë Shqipëri, dhe kudo gjetëm gjithçka na duhej. Ju tha nëse li- bri ju ka pëlqyer, kjo gjë na gëzon shumë, por dhe ne presim me shumë gëzim çdo gjë që ju do të na shkruani për vendlindjen tuaj.

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"

## BURRNESHA...

E quajnë Shpresa Mati. Një grua vërtetë burrëshë. Në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Jeton me familjen e saj në qytetin e vogël



Talentino, jo larg Ankonës dhe shumë pranë Macerates, qytetit që u capërlua dhe u rrënua nga termeti disa muaj më parë.

Meshallesh dhe rrezikut për jetën, çau Adriatikun dhe, si mijra e dhjetra, mijra të tjerë shkoi edhe Shpresa në Itali. Nëntëm- bëdhjetë vite më parë. Me familjen e saj, bashkëshortin Samir, vërtetë njeri i mirë, i shkathët dhe praktik, si dhe me dy fëmi- jët e vegjël, Marselin dhe Marsidën, (i qua- jtën kështu sepse të dy u lindën në muajin Mars). Shkuan me shpresën për të siguruar një jetë më të mirë, duke lënë Shqipërinë në përgjithësi dhe Shkodrën e tyre, në rrëmuje kolapsi dhe në prag të një lufte civile.

Shpresa dhe burri i saj Samiri, si njerëz

të thjeshtë dhe të mësuar me punën, ishin të bindur se edhe atje, në Itali, vetëm me punë dhe me ndershmëri mund ta siguronin mirëqenjen. Ndaj që në ditët e para, pasi futën kokën në një apartament të vogël, pa- guan me ata qyq kursimesh që kishin sjellur nga vendlindja, qeranë e kripur për gjashtë muaj dhe siguruan fëmijët në shkolla dhe çerdhe, u vunë në kërkim të punës, sido të ishte, e rëndë, ditën apo natën.

Samiri gjeti punë në një firmë ndërtimi, si murator, ndërsa Shpresa në një fabrikë këpucësh ku punonte nëntë orë në ditë dhe pasi linte punën në fabrikë vraponte të bënte edhe piataralësen në një piceri dhe këthehej në shtëpi natën vonë, kur Samiri kish ush- qyer fëmijët dhe ata flinin. Dhe fëmijët tako- heshin me nënën e tyre vetën ditën e dielë, sepse Shpresa ngrihej më natë, u bëntë gati mëngjesin burrit e fëmijëve dhe nisej për në punë, ndërsa tjerët flinin. Nisej herët sepse punën e kishte larg qytetit, ndaj vraponte të zinte autobuzin për të kapur fabrikën fiks në orar...Përndryshe humbiste punën.

Me këtë stërmundim, por duke mos u an- kuar kurrë, për një dekadë vitesh, nisen, si të thuash ta "mirnin veten". Duke kursyer, (por jo për fëmijët), arritën të bëjnë një jetë disi komode. Samiri krijoi pas disa vitesh një firmë ndërtimi të vetën, ku punësoi bashkëkombas emigrantë nevojtarë. I mësoi të birit, Marselit zanatin dhe djali, që në moshën 14 vjeçare u bë mjeshtër për ndërtim skelash. Tani për familjen gatuate vajza Marsida...Shkollën, dy fëmijët e vazhdonin natën dhe shkëlqenin në mësimë...

Ëndërr e çdo emigranti në Itali është të kete një shtëpi të vetën, të blejë një apar- tament apo të ndërtojë një shtëpi. Shpresa dhe Samiri e realizuan këtë ëndërr. Blenë një truall në Tolentino. Blenë dhe materialet e

nevojshme, ndërsa shtëpinë e ndëruan vetë, me krahët e tyre. Duke punuar të gjithë, edhe natën. Punonte edhe Shpresa, bile edhe Mar- sida....Dhe ngritën një vilë të mrekullueshme, me plot dhoma, me verandë, garazh ,bile dhe me kopësht, ku mbollen shumë pemë fru- tore. Nuk harruan te gdhënin në murin krye- sor dhe ne kangjellat prej hekuri dy shqiponja dykrenare. Bile, kryelarti Samir stampoi në mur dhe flamurin tonë kuq e zi.

E mobiluan shtëpinë mësimi dhe ishin aq të lumtur, sepse kishin një shtëpi "të tyrën" dhe nuk do paguanin më qeratë e kripura...Të lumtur se edhe gjëndja e tyre ekonomike qe përmirësuar ndjeshëm.

Por....Një fjalë ë urtë shkodrane thotë "Nuk të lë Zoti rehat".

Ra një termet i tmerrshëm që rrafshoi qytetin Macerata. Lëkundjet ogurzeza nuk kursyen as Tolentinon...As shtëpinë e bukur të familjes Mati. Muret u çanë, dhe u shëmb... Për fat pa viktima. Por trauma që shkaktoi ishte e madhe. Të shohësh se si shëmbet brenda pak minutash ëndrra kështjellë për të cilën je rropatur për dy dekada pune e stër- mundimi është shumë e rëndë. Një peshë që të kërrus supet dhe shpirtin....

U strehuan për shumë kohë në diskon që kish ngritur në qytet Marseli i shkathtë dhe me shpirt biznesmeni. Barren e rëndë, fat- keqësinë e madhe e duroi shpirti i Shpresës por jo Samiri. Ai pesoi një traumë që e bëri të zërë shtratin. U sëmur rëndë. Shpresa deshi ta dërgojë në ndonjë klinike italiane, por Samiri ngulte këmbë ta dërgonin në ndonjë spital të Tiranës. Shpresa me dhimbje në zemër e kuptonte të shoqin. Ai donte të vdiste në Shqipëri. Dhe ashtu ndodhi. Vdiq pas disa ditësh në Tiranë. Një traumë e tmerr- rëshme për gjithë familjen, por sidomos për Shpresën. Brenda pak kohësh, ngeli pa

shtëpi dhe mbi të gjitha pa burr. Në moshë të re, në kulmin e energjisë...

Por shpirti i Shpresës ishte i fortë. Në të gjallonte ajo thënja biblike: "Bëje jetën të dobishme edhe kur ajo të bëhet e padu- rueshme". Se jeta vazhdon dhe ti duhet t'ia pish lëngun e saj deri në piklën e fundit...

Pasi i bëri në Shkodër gjithë ceremonitë e zakonit, me "të shtata e të dyzeta" u kthye në Itali, tashmë në qytetin bregdetar Civitanova ku zuri me qëra njeri shtëpi. Dhe ashtu, e ve- shur në të zeza mori frerët e shtëpisë, u bë burrëshë mbi burrëshat...

Shkon çdo ditë nëpër shkollat ku mësojnë fëmijë shqipëtarë, u rri pranë që të integro- hen, të mos e ndjejnë vehten inferiorë dhe të bëhen pre e bulizmit....Ndihton shpirtërisht dhe financiarisht familjet shqipëtare në nevo- jë, biles, kur varfëria e papunësia i shtyn ata në prag divorci, bën çmos t'i pajtojë dhe t'i ndihmojë, t'u gjejë punë...Ndihton të birin, Marselin të vazhdojë punën e babait, në fir- mën e ndërtimit, i rri vajzës mbi kokë të për- gattit sa më mirë për provimet që e presin në fakultetin e drejtësisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" ku bën vitin e tretë ,(Marseli e ka mbaruar këtë fakultet dhe po jep masterin), nxit Albën, bukuroshen vlonjate, të fejuarën e Marselit, të vazhdojë vitet që i kanë ngelur në fakultetin e gjuheve të huaja, anglisht....

Natën vonë, kur shtrihet të flejë, i hedh një sy dhomës si muze ku qëndron në ball foto- grafia e Samirit. Me shpirt i thotë: -Zemër, ti nuk ke vdekur. Punën tënde, ëndrën tënde do ta vazhdoj unë...Deri në fund...Shtëpia që ndërtove dhe na e rrënoi termeti...do të ngri- het në këmbë...Të betohem! Se janë shqipon- jat dykrenare atje....

A nuk është një "burrneshë" Shpresa Mati?

Nga FADIL KRAJA

# PRANVERË ME KËNGË SHKODRANË

“Pranverë me këngë shkodrane”, titullohej koncerti me këngë qytetare që u ngjit në skenën e Teatrit “Migjeni”, duke sjellë bashkë me pranverën, bashkë me aromën e luleve të këtij qyteti të mrekullueshëm edhe interpretimet e këngës së pavdekshme shkodrane, e asaj kënge që prej qindra vitesh jeton dhe bëhet gjithmonë e më e bukur, si një lule që sa herë vjen pranvera çel dhe shpërthen, duke sjellë aromën e oborreve, bahçeve, kopshtijeve dhe livadheve të këtij qyteti kaq të mrekullueshëm.

Kështu erdhi edhe këtë pranverë kënga shkodrane, si një drandofile që përtërihet, zbukurohet dhe bëhet një buqetë pranverore, dhuratë për qytetin ku ka lindur.

Këto që po shkruaj nuk janë elozhe për këngët dhe lulet shkodrane që i njohin të gjithë, por janë lëvdatat që meritojnë ata të cilët nëpërmjet këngës dhe zërit të tyre të mrekullueshëm sjellin gjithmonë në Shkodër pranverën.

Kështu solli edhe këtë mars pranveror aromën e kësaj stine grupi i muzikantëve dhe këngëtarëve shkodranë që u ngjit në skenë si buqetë me gonxhe dhe trëndafila.

Koncerti u hap me këngën “Pranvera filloj me ardhë” interpretuar nga dy grupe këngëtarësh të rinj, të cilët gjatë gjithë koncertit shoqëruan këngëtarët që ishin pjesëmarrës.

Për kënaqësinë e tyre po shkruaj emrat e këtij ansambli këngëtarësh të mrekullueshëm që performuan në tempullin e Teatrit “Migjeni”: Bujar Qamili, Mukades Çanga, Vjoleta Zefi, Orjeta Kelaj, Luigj Alia, Rezarta Smaja, Hajro Pepa, Leonora Çuliqi, Leonard Guga, Blerta Cina, Indrit Mlika, Marjana Begu, Laorjan Ejlli, Ylber Tahiri, Xhuli Pjetraj, Ilsi Ademi, Klodiana Vata, Ardian Tanushi, Artemisa Mithi, Ademir Fresku, Niki Mjeda dhe Riad Bashi.

Ky ansambël këngëtarësh të përkryer u shoqërua nga orkestra e mrekullueshme e përbërë nga instrumentistët profesionistë: Ilir Zoga, fizarmonikë, Namik Jahja dhe Indrit Kodraliu, klarinetë, Anton Kaf talli dhe Edmond Denelli, violin, Fatmir Mesi, bateri, Bledi Doçi, bass dhe Dritan Mlika, kitarrë.

Publiku shkodran, gjithmonë i pasionuar pas këngës së qytetit të vet, për dy netë me radhë mbushi sallën e teatrit i entuziazmuar, por edhe me falenderime të mëdha për organizatorët që duhen lavdëruar për këtë punë të madhe që kanë bërë.

Ata janë Bashkia e Shkodrës dhe Teatri “Migjeni”, të cilët me bashkëpunimet e tyre i sjellin qytetit një gjallëri artistike që ndoshta kishte kohë që i mungonte.

Koncerti “Pranverë me këngë” është pra kështu një aktivitet që pason festivalin “Luleborë”, meritë e Bashkisë së Shkodrës, të performuar në dhjetorin e vitit të

kaluar, të rikthyer pas 30 viteve me krijime dhe interpretime të reja.

Duke u rikthyer te ky aktivitet kaq i bukur dhe kaq i mirëpritur nga shkodranët, duhet të nënvizojmë se, të organizosh një koncert të tillë, aq më shumë në Shkodër nuk është e lehtë.

Këto netë në skenën e Teatrit “Migjeni” këta spektatorë të mrekullueshëm kërkojnë t’i përjetojnë si netë magjike. Për të arritur atë që kërkojnë ata janë përgatitjet e mëdha që bën grupi i këngëtarëve, muzikantëve, orkestruesëve dhe orkestrës në skenë, të drejtuar nga maestro Ilir Zoga,

lule pranverore të këngës, prezantuesja, por dhe regjisorja e këtij spektakli, aktorja e mirënjohur Merita Smaja, e cila me aftësitë e saja dhe me dashurinë që ka për qytetin e Shkodrës, transmetoi në sallë vlerat e këtij aktiviteti, por dhe të secilit nga interpretuesit.

Ishin 24 këngë në këtë buqetë që u performuan dy netë me radhë, por që vijnë në qytetin e Shkodrës për të dytin vit radhazi, tashmë si një kërkesë e publikut, por dhe si një mundësi për të krijuar një traditë në qytetin ku gjithmonë janë kënduar këngë për lulet, për pranverën dhe

“Pranverë me këngë” solli pra kështu në Shkodër këngët dhe zërat e kësaj stine kaq të bukur, e cila është e veçantë në këtë qytet, sepse lidhet me festa dhe rite shumë të lashta, të cilat shquhen pikërisht për festimet e tyre me këngë, valle e gosta tradicionale.

Shfaqje dhe koncerte të tilla, Shkodra i ka pasur gjithmonë traditë brez pas brezi. Edhe kur nuk janë organizuar në institucione, kanë qenë festa popullore, të cilat kanë lënë pas emra të shquar që nga ahengxhinjtë e vjetër shkodranë, e deri te artistët e shquar Bik Ndoja e Shy-



nën kujdesin e drejtoreshës së Teatrit “Migjeni” znj. Rita Gjeka.

Emocionet janë të mëdha. Emocione ka edhe këngëtarë mbi të rinj, por edhe më të njohurit, emocione ka edhe Bujar Qamili, por edhe këngëtarja e re Niki Mjeda, emocione ka edhe Vjoleta Zefi, por emocione ka edhe këngëtarja e re Klodiana Vata. Emocione kanë të gjithë, sepse me performancat e tyre sollën këtë pranverë aromën e këngës shkodrane në një format të veçantë, ku ndërthurja e interpretimeve të këngëtarëve të vjetër dhe të rinj, ngjasonte me një bahçe të mbushur me lule dhe me gonxhe.

Për dy netë me radhë këto lule dhe gonxhe shpërthyen dhe i dhanë aromën e këngës shkodrane, jo vetëm sallës, por gjithë qytetit.

Si një bahçevane profesioniste doli në këtë skenë për të përkëdhelur dhe prezentuar, për t’i prekur dorë për dorë këto

dashurinë.

Ky pra është qyteti ku të gjithë këndonë, kjo pra ishte salla ku të gjitha këngët që u performuan, u kënduan dhe u duartrokitën, duke krijuar një atmosferë të mrekullueshme, si një festë a si një dasëm që vetëm shkodranët dijnë ta gëzojnë së bashku.

Për të realizuar këtë shfaqje, këtë koncert kaq të mirëpritur të këngës popullore qytetare shkodrane, duhet lavdëruar përkujdesja e Bashkisë së Shkodrës, por duhet të evidentohet përkushtimi i znj. Bruna Keçi (Lleshi), që mbulon sektorin e kulturës dhe puna e palodhur e drejtuesit artistik të këtij koncerti z. Ilir Zoga që tanimë mund të themi pa frikë se është një nga profesionistët që mban gjallë çdo vlerë të traditës që qyteti i Shkodrës ka ruajtur dhe kultivuar në shekuj.

Maestro Ilir Zoga kishte zgjedhur repertorin nga perlat e këngëve.

qyri Alushi, për të ardhur deri në ditët tona, me një brez të mrekullueshëm këngëtarësh, duke treguar kështu se pranvera e këngës shkodrane do të jetë e përjetshme si vetë pranvera.

Në mungesë të të madhit Bik Ndoja, “Mjeshtri i Madh” Bujar Qamili interpretoi një jare shkodrane, “Nji kllaf me ar’ ta çova” dhe më pas këngën “Kur të pash moj lule”, i cili duke ngritur publikun në këmbë, tregoi kështu se Jaret Shkodrane gjithmonë kanë dhe do të kenë trashëgimtar për interpretimin e tyre.

Koncerti u mbyll me një potpuri shkodrane: “Luleborë”, “Si dukat i vogël je” dhe “S’ka ma t’bukur se pranvera”, ku përveç 24 këngëtarëve që këndonin të gjithë së bashku, dëgjohej fuqishëm edhe zëri i publikut në sallë, i cili i shoqëroi ata deri në fund të spektaklit.

Nga RAMAZAN ÇEKA

# ANTON GRISHAJ - GAZETARI DHE POETI I NJË PROFILI TË VEÇANTË

Ka ndarje dhe ndarje nga jeta. Ka ndarje që të marrin me vete si rrezatim ndjeshmërie, respekti dhe investimi moral, qytetar dhe intelektual, që mbeten të pashlyera, jo thjesht brenda një rethi të ngushtë jetësh njerëzore, por shumë më gjërë. Kjo e fundit ndodh pikërisht atëhere kur ndarja nga jeta konvertohet pashmangshmërisht në memorjen e njerëzve nga një fjalë në vete në ngjizjen si memorie e përhershme respekti, dashurie dhe kumti jetësor. Një të tillë ndarje përjetoi familja Grishaj, në kryeqytetin tonë, Tiranën më 17 prill 2017. Pikërisht në këtë ditë, në ora 9.15 minuta, paradreke, në prani të nënës së tij që e deshi dhe e nderoi aq shumë, në prani të Dritës, shoqes së jetës dhe dy fëmijëve, Adit dhe Aidës, sikur motrës, vëllezërve dhe xhaxhait, ndahet nga jeta gazetari dhe poeti, producenti dhe skenaristi, telekronisti i parë i televizionit shqiptar për Malësinë e Madhe, bashkëpunëtori dhe kolegu nga më të vlerësuarit, brenda dhe jashtë vendit, në jetën e gazetarisë televizive shqiptare, shoku dhe miku ynë malësor, frymëzuesi i idealeve demokratike, mjeshtri i sensacionit dhe po aq poeti Anton Grishaj, që diti të sfidojë keqas moralisht edhe vdekjen duke evokuar deri në çastet e fundit të jetës dimensionet e paimagjinueshme të shpirtit:

*Në mugëtirën e natës / Kam pare vetëtimat / Tek skuqnin / E tek shqyenin Qiellin / E s'jam trembur*

do të shprehej me gjuhën e shpirtit në librin e tij, "Amaneti i pa lënë", pas dy vëllimeve të mëparshme me poezi, si një amanet për të gjithë ata që i deshi dhe e deshën, që jetuan dhe shoqëruan, nga afër apo në distancë në tërë jetën e tij, vërtet të shkurtër, por interesante, si i lindur për të komunikuar me buzë në gaz me njerëzit, edhe atëhere kur vdekja ia kishte këputur të gjitha rrënjët e shpresës për jetën. Më 18 prill 2017, në një rën nga mjediset publike, pranë Kishës së Qytezës së Bajzës, nga ora 9.00 deri ne ora 13.00. familjarët, miqtë dhe shokë bënë nderimet e rastit pranë arkivolit të Antonit duke ngushlluar nënën, familjen, vëllezërit, xhaxhain dhe gjithë njerëzit e gjakut të tij. Në shenjë nderimi dhe respekti, me ndjenjen e përgjegjësisë morale dhe institucionale, se shumë më tepër duhet bërë për jehonën publike ndaj vlerave të tilla, si Anton Grishaj, që i bëjnë nder Malësisë dhe gjithë Shqipërisë, në ora 9.00, në emër të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Malësisë së Madhe, së bashku me Dakë Keqajn, nënkryetarin e këtij komuniteti krijues dhe poetin Tonin Kaçaj bëmë nderimin e rastit. Do të jenë Grishajt, vendlindja e tij që në ora 14.00 do ta presë djalin e saj të prehet në banesën e fundit, pranë varrit të të tatit dhe të të afërmëve të tjerë. Në këtë prani nderimi dhe respekti për Antonin deri në banesën mortore e përcollën, krahas familjarëve dhe të afërmëve të tjerë, edhe shokë dhe miq, bashkëstu-

dentë e bashkëqytetarë sa malësorë, sa nga kryeqyteti ku banoi prej vitesh, si: deputeti i M. Madhe, z. Paulin Sterkaj, i cili së bashku me kryetarin e Bashkisë Malësi e

Hoxhën, përmes dy specialeve kushtuar Anton Grishaj, ku ra në sy sidomos specialja e paraqitur nga gazetari koplikas, z. Gëzim Vuçaj. Këtu duhet të merrnin



Madhe, z. Toni Marinaj, deputeti Gjovalin Bzheta, shok dhe mik i tij, bashkëstudentë e bashkëpunëtorë në qeverisjen lokale 1992-1996. Njëherish si bashkëstudentë, bashkëpunëtorë si gazetar apo si bashkëautor të shumë filmave dokumentarë si: Spartak Padhimitri, Marash Mirashi, gazetar i TVSH-ës, Zef Gjeta "doktor" i shkencave bujqesore, njëri nga shokët më të afërm të tij, botuesi i librit të tij të fundit "Amaneti i pa lënë", Ilir Shordja, Prof. Gaspër Koka si mik, si shok, si bashkëmalësor, por edhe si pronari i televizionit "Rozafa" që pati fatin të përcjellë për shume vite bashkëpunimet elegante dhe me aq përkushtim të Anton Grishës. Vlen të nderohet në këtë rast përcjellja elektronike që i bënte televizionet "Rozafa" Shkodër, me pronar z. Gaspër Koka si dhe televizioni "Kopliku" me pronar z. Zenel

shembull mediat tjera lokale që heshtën, ndërsa po e rregjistronte me aq seriozitet operatori i RTVSH. Shoku tjetër i Anton Grishajt, bashkëstudenti Sytki Ndrecaj, nënkryetar i Bashkisë Koplik, jo thjesht do të gjendej pranë familjes në homazhin kushtuar të ndjerit Grishaj, por po aq do të sensibilizonte menjëherë opinionin në kohështrirjen e tij në fejbuk për humbjen e një shoku, miku dhe malësori të nderuar. Ndërkohë Tonin Kaçaj, njëri nga adhuruesit e shoqëruesit aktivë të kontributit serioz të Grishajt, kontribut të cilin e ka ndjekur dhe shoqëruar po aq edhe si një konsulent, me ftesën e mikut dhe shokut të tij Anton Grishaj, kujton me shumë respekt disa prej atyre çasteve të pashlyeshme në memorjen e tij rreth peshës elegante të Grishajt, sidomos si kineast, producent i dokumentareve nga

më të vlerësuarit, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Prolog i afirmimit të tij me filmin dokumentar, pra filmi i parë i tillë do të jetë dokumentari kushtuar jetës dhe veprimtarisë shoqërore dhe aritistike të deputetit të parë të opozitës demokratike shqiptare në Malësinë e Madhe, shokut dhe mikut të tij, poetit të talentuar Dodë Kaçaj, në vitin 1998. Sukseset në këtë fushë brilante të kontributit të Grishajt do të bëhen nga më bashkëdhëtarët gjatë gjithë karrierës së tij. Kështu në konkursin kombëtar të vitit 2000, në Teatrin Popullor, ku merrnin pjesë edhe konkurentë te tillë, të shquar si Petrit Ruka, me filmin dokumentar "Harresa e madhe", me motive nga jeta e emigracionit shqiptar të viteve "90-të", Grishaj do të konkurojë me tepër sukses duke fituar Çmimin e Parë me dokumentarin "Gjakmarrja" me motive sociale të mirënjohura, sidomos pas rënies së shtetit shqiptar, në mars 1997. Hap pas hapi sukseset e tij bëjnë që Grishaj të kalojë pa shkuar shumë kohë nga filmi dokumentar tek filmi artistik. Madje, gazetari veteran i televizionit shqiptar Marash Mirashi, Anton Grishajn e vlerëson si themeluesi i telenovelave shqiptare. Numri i atyre që kanë dëshirë të thonë fjalën e tyre të ngrohtë për marrëdhëniet me Antonin dhe kontributin e tij veçanarisht si producent, kineast apo si autor i dhjetëra dokumentarëve televizivë në këtë ditë dhimbjeje, për humbjen e tij fizike, për të gjithë që e njohën është jo i zakonshëm. Falë një kontributi shumëdimensional si gazetar televiziv, kineast apo si producent i filmave artistikë, si: "Letra fatale", "Pleqtë e hashashit" si dhe filmi vizatimor "Koha e dashurisë së akrepave", pa haruar produksionin e 37 dokumentarëve televizivë, 21 filmave dokumentarë, si bashkëpunim, me Fondin shqiptar të Zhvillimit, si dhe 6 serive të telenovelës "Familja", një bashkëpunim me RTSH, janë dëshmia më autentike e një producenti tejet të suksesshëm. Jo rastësisht, sot dhe mot Anton Grishaj do të kujtohet dhe nderohet për një seri vlerësimesh, si inkurajime serioze të mëtejshme, në karrierën e tij të suksesshme, siç janë nderimi gjatë veprimtarisë së tij, të sipërcituar, me: Çmimin e parë në Festivalin Botëror të Filmit Dokumentar, në Milano, me temë sportive, për filmin "Lidhëzet e këpucëve", Çmimin e dytë në Festivalin Botëror, në Bjellorusi, për filmin "Bertinus", kushtuar kodikëve të Beratit dhe Çmimin special për nder të jubileut të 20-vjetorit të Gazetarisë Shqiptare. Ky ishte Anton Grishaj, zëri ynë dinjitoz, me dinjitet moral dhe profesional si gazetar, telekronist, kineast, producent dhe krijues, që na mbloodhi në këtë ditë dhimbjeje, Ky ishte Anton Grishaj gazetari dhe poeti, kineasti dhe producenti i një profili të veçantë.

Kadri Ujkaj

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

### ME KANUNIN, PA KANUNIN

Kanuni pat vlerat e veta  
Për kohën e deshti jeta  
Ai ishte kushtetute kombëtare  
Me burri e kulture shqiptare  
Ishte ligj paqësor për rregullsi  
E ndërtuan burrat me mençuri  
Për sistemin e jetës sheqerore  
Me normat e marrëdhënieve njerëzore  
Kishte karate e respekt vëllazëror  
Me pajtim shpirtëror burrnor  
Për kohën me vlere të madhe  
Me aftësi e ndjenjat humane  
Rregullues e paqësues i çdo problem  
Te drejtën e ushtronte kuvendi  
Me kompetenca të arsyes paqësore  
Ruajti rregullat e traditës zakonore  
Gjithmonë qetësues e kurrë denigrues  
Me ide e frymë rregulluese  
Misioni paqësor ishte i nalte  
Me vlerësim të barabartë  
Gjithçka me mirëkuptim  
Kuvendi i pleqve jepte vendim  
Mbet simboli i kohës së lashtësisë  
Ne testamentin e historisë  
Ishte model i burrërisë  
Avokati i vlerave të drejtësisë  
Orientues e udhëzues për pajtim  
Dhe në Evropë pat vlerësim  
Në Shqipëri përkrahje gjeti  
E zbatoi populli, e njohu shteti  
Në kohën pa ligje gëzoi autoritet  
Për vlerat në kohën e vete  
Jeta pësoi ndryshime  
+ Here qetësi, here ashpërsime  
Kur shteti komunist mori drejtimin  
Vendosi ligje, ushtroi shtrëngimin  
Krijoi qetësi, bëni çarmatimin  
Popullit iu krijua siguria  
Me ligje u izolua hasmëria  
Te në pati shume vlere  
Se kishim jetua asnjë here  
U krijua bashkëjetese absolute  
Po frike terrori e pushke  
Jetuam një qetësi, një jete tjetër  
Kanuni u quajt dogmë e vjetër  
Ligjet e reja gëzuan autoritet  
Me jetëgjatësi 45 vjet  
Grindjet e hasmëritë morën stabilitet  
Shqipëria jetoi në "unitet"  
Tranzicioni solli tjetër ndryshim  
Në ekonomi, kulture e drejtim  
Pa vlere evoluim shpejte  
Në marrëdhëniet popull shtet  
Te gjithë u bane politikan  
Pa merite, aftësi e taban  
Me një kulture denigruese  
Normat e shoqërisë, jo funksionuese  
U prish model i respektit psikologjik  
Te drejtat e liritë krijuan konflikt  
Pa aftësi pushtet me marre  
S'dimë ku shkojmë, harruam prejardhjen  
Prejardhjen e kemi me lavdi  
Te paret tanë, bane e lanë histori  
Për lufte, paqe e urti  
Sa te huajt patën zili

Jetoi në emigrim  
Mendja e shpirti në vendin tim  
Në moshe të vjetër jam  
Trazime në shpirt kam  
Kur shoh lajmet në ekran  
Krime e ngjarje pa mbarim  
Nënat në vaj plote trishtim  
Fëmijët të stresua pa shkollim.  
Me ardhjen e "demokracisë"  
Ndryshuan marrëdhëniet në jetën e shoqërisë  
Kryesisht hakmarrja e pa drejtësi  
Burrat vetburgim nëper shtëpia  
Te grat e fëmija veprim pa arsyeja  
Në kanun a në ligj nuk asht pa  
Me u vra fëmija e gra  
S'po njihet fisi, vëllai e djali  
As nderi, as vatani  
Burrat patën vlere shekullore  
Bane lufte e ruajtën troje  
Mbajtën besën, tradita e zakone  
Kur burrit i preket ndera  
I vritet morali e i bijën vlere  
I grabiten djali e vajza të dera  
E tregtohen në shtete të tjera  
Kur mungon forca e ligjit  
Duhet gjete rrugët e pajtimit  
Ashte kohe e qytetërimit  
Kemi kulturën e të drejtës morale  
Me qetësi e arsye, të kërkojnë falje  
Shkencërisht, falja ashte e vështire  
Kur burri e bane me dëshire  
Mbetet simbol në shoqëri  
Për trim, besnik e shpirt bujari  
Me kulture e urti  
Ky ashte karakteri burrëror  
Qe na dhuruan të paret tanë  
T'i thërrasim ndërgegjes e arsytimit  
Te ndërtojmë jetën e vllaznimit  
E dënojmë armët e mjerimit  
Te pajtojmë ngatërresa e gjaqe  
Fëmijët t'i lame në qetësi e paqe  
Arsyen Zoti na ka dhanë  
Jetoni në paqe na ka thane  
Token këtu e gjetëm, këtu po e lame  
Te prinë nderi e bamirësia  
Dhurate na ka dhanë Zoti  
Te bashkohemi dore për dore  
Në misionin e madh paqësor  
Ashte në nderin e lavdinë e kombi tone.

**Pjeter Gera,**  
**Belgjike**

### KUR JETA FALET PËR ATDHE!

Me 7 prill tridhjetë e nanë  
Erdh Italia me danamë  
Porsa në breg dalin danamët  
Mbreti iku nga sytë kamët!

Iku mbreti, frikacaku . . .  
Por jetën, Atdheut, ia fali  
Mujo Ulqinaku

Ai luftoi trimërisht  
Deri sa jetën e dha heroikisht

Kur nga fashizmi u pushtue Shqipëria  
Gjithë vendin e mbuloi zija!

Populli me demonstrata  
Si një trup i vetëm i bashkuar  
Kërkoi armë për të luftuar  
Por mbreti i kishte fsheh se i kishte tradhëtuar!

Kishte tradhëtuar mbreti  
Me tradhëtar nga të gjitha anët  
Pushkëve u kishte hek shulat  
E topave gjilpanat!

Mbreti pati premtue se malit do dilte  
I veshur me opanga  
Dhe do luftonte me pushkë pa shula  
E topa pa gjilpana. . .!

Por malit, nuk dolën armët  
As topat tanë  
Por malet u mbushën  
Plot me partizanë.

Luftuen maleve  
Për çlirim kombëtar  
Trimat partizanë kundër pushtuesit  
Dhe bashkëpunëtorëve të tij tradhëtarë!

Këta këmishëzi e faqezi  
Me karvanë shumë të gjatë  
Udhëtuan për veri.

Kur arritën në Bushat  
Nga turma e popullit të zemrum  
U shkëput një burrë guximtarë  
Trim e atdhetarë.

Përpara u doli dhe u tha:  
Ndaluni fashistë, ndaluni, ku shkoni  
Ndaluni këmishzi  
Këtu çfarë doni!

Ky asht atdheu ynë  
Pa shkelë mbi trupin e gjakun tim  
Këtu nuk kaloni!

Por fashistët gjakatarë  
Me plum ty të ranë  
E gjaku yt u derdh rreke  
Ti gjakun tan derdhe për atdhe!

Dhe kur po jepje shpirt  
Dhe fryma erdh me dalë  
Ti sytë i hape për të fundit herë  
Dhe the: Hallal gjaku im ty atdhe  
Për ty jam krenarë!

Kështu vertetove se kush për atdhe  
Jetën falë e ka  
Frikë nga vdekja pas nuk ka!

**Ndue Mici,**  
**Shkodër**

### REDAKSIA

**Kryeredaktor: Luigj Shyti**

**Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja**

Mundësoi  
botimin:

**EDMOND TËRTHORJA**

